

## **Popull i tradhëtuar (Botuar ne 1998)**

Sikur luanët të kishin mundësi ta shkruanin vetë historinë, ajo do të ishte ndryshe nga historia që kanë shkruar gjuetarët

Redaktor Apostol Duka

Recenzent

Frrok Cupi

Shaban Sinani

Naim Zoto

Kopertina : Vladimir Myrtezai

Punoi në kompjuter : Florian Haxhihyseni

Ky libër nuk mbaron me faqen e fundit si shumë libra të tjerë.

Do të doja të shfaqja një vlerësim mbase të papritur për lexuesin : ky nuk është një libër për të gjithë

Cfarë paska ndodhur vallë ? Ky libër ka probleme moshash apo sekreti ? As njëra e as tjetra. Libri “ Popull i tradhëtuar ” i Koço Danaj, që në titull tregon se nuk mund të jetë i përshtatshëm për të gjithë. Cila kategori nuk e do këtë libër ?

1-Eshtë kategoria popullore e “ besimtarëve ” të ngrohtë. Këta janë njerëz të mirë, por i mëshojnë vetvetes me të drejtë dhe pa të drejtë, që ta detyrojnë vehten e tyre të besojë ato që thotë dëshira dhe jo atë që shikon syri dhe mëndja. Në Shqipëri tani ka shumë njerëz të tillë, sepse sapo është ndërtuar një qeveri e re e pas-krizës më të egër që ka parë ky vënd. Në këto kushte njerëzit kanë frikë se mos ju prishet kjo qeverisje, ose akoma më keq : se mos ju vjen përsëri periudha shkatërruese e Sali Berishës. Prandaj dhe kanë të drejtë të mbyllin sytë e të luten : “ Aman, mos më thuaj ndonjë fjalë të keqe për këtë qeveri ”. Eshtë mjaft njerëzore dhe deri diku normale për këtë kategori. Këta nuk kanë përse e lexojnë qysh sot librin e Koço Danaj. Mund të presin për një periudhë të mëtejshme, ndoshta periudhën kur këta njerëz do të jenë mërziur me qeverinë e tyre, dhe atëhere libri do të jetë një ilaç për ta.

2-Këtë libër mund të mos e lexojnë ata që kërkojnë të tilla shkrime që shpesh quhen “ simite furre ”. Edhe këto janë shkrime të mira sepse e tregojnë ngjarjen aty për aty. Shpesh herë këto shkrime, mbase dhe libra dalin në konkluzione të gabuara përgjithësisht. Natyrisht kështu do të ndodhë përderisa ngjarjen e ke aq pranë fytyrës sa që nuk mund ta shikosh të tërën. Por ka dhe mjaft lexues që e duan ngjarjen të përshkruar dhe të analizuar aty për aty, edhe pse të papjekur mirë. Këta nuk kanë përse ta lexojnë këtë libër. Sepse libri “ Popull i tradhëtuar ” i lodh ata. Ky libër e ka pritur ngjarjen e Pranverës së egër 1997, që të distancohet pak nga pak, në harkun e një viti e pastaj e ka analizuar. Eshtë njësoj si me aparatit fotografik, që nuk pranon të fotografojë aq afër sa

të dalë fytyra në flu ose dhe e deformuar. Edhe aparati fotografik e kërkon një distancë të caktuar që të të japë portret të vërtetë. Aq më shumë ngjarjet historike. Koço Danaj e ka “ përgjuar ” kohën deri në momentin kur portreti i ngjarjeve të fillimit të vitit 1997, është shfaqur si një hënë e plotë prapa malit plot me paragjykime , errësirë informative, pasione etj. Letërsia jonë politike ka shumë nevojë për libra të tillë.

3-Do të ishte mirë të mos fillonin ta lexonin librin edhe ata lexues që pëlqejnë të kenë ngjarje të rrafshta, të buta, të tjerrura si në netët e dimrit. Edhe këto bëjnë pjesë në një letërsi të përlqyeshme. Por kjo kategori lexuesish nuk do të ndjeheshin mirë me këtë libër. Arsyeja është se ky libër ka deduksione dhe jo përshkrim të ngjarjes dita me ditë ose ora më orë ; ky libër ka analizë politike dhe filozofike dhe jo “ tale ” ; ky libër nuk mbaron me faqen e fundit si shumë libra të tjerë. Mund të them se në faqen e fundit, lexuesi fillon të mendohet më shumë për atë që ndodhi në vitin 1997 në Shqipëri. Prandaj mendoj që të paralajmëroj lexuesin për vlerën e këtij libri : Nuk është libër për të gjithë.

Frrok Cupi

Një libër që e njeh “ hilenë ” e historisë për të fshehur vetvehten

Prej kohësh më ka shqetësuar rreziku i mjegullimit dhe errësimit të historisë së dhimbëshme të ngjarjeve të vitit 1997. Shkrimtari Dritëro Agolli e pati shfaqur i pari këtë alarm, duke u shprehur se në një vënd të qytetëruar dhe në një shoqëri që funksionon mirë, për këto ngjarje duhet të kishin vërsuar botimet, duhej të ishin botuar libra. Ndërkaq siç dihet në muajt më të rëndë të atij viti edhe shtypi i përditshëm ishte i ndaluar, për shkak të gjëndjes së shtetrrëthimit. Pak kohë më parë një komision i posaçëm parlamentar paraqiti raportin e vet mbi zhvillimet e trazuara të vitit të kaluar. Ishte me të vërtetë alarmuese pyetja që bëri një nga deputetët : “ Vetëm kaq di komisioni ? Po të jetë për kaq, jo ne, por dhe ajo pjesë e popullsisë që i ka ndjekur ngjarjet përmes ekranit televiziv, di më shumë se komisioni ”.

Ideja e tmerrshme se “ historia është e prirur për të fshehur vetvehten, më kishte trëmbur aq shumë, sa që kur mora për të lexuar librin “ Popull i tradhëtuar ”, bashkë me kumtin e autorit se “ ky libër u kushtohet ngjarjeve të vjetshme ”, gjëja e parë që më shkoi ndërmend ishte të vëreja se a ka mundur autori ta njohë këtë hile të mbrapshtë të historisë dhe si ja ka dalë mbanë të zbulojë atë që priret të shmanget prej zonzës së njohjes.

“ Popull i tradhëtuar ”, është libri i parë që përpiqet ta kapë historinë sa pa u larguar e pa u vështirësuar për të mbritur tek e vërteta. Unë nuk di nëse autori e ka pasur në mendje në formë të shprehur atë ide që më trëmbte mua, mendimin se historia e fsheh vetvehten, por jam i bindur se diku në vetëdijën e tij, apo në nënvetëdije ka qënë i njëjtë preokupim.

E çmoj këtë libër para së gjithash, për këtë kontribut. Historia ndërtohet me referenca. Të parat referenca janë letërsia dokumentare dhe ajo e analizës. Ne nuk patëm reporterë në këtë periudhë të vrazhdë për një njohje të drejtë për drejtë nga vëndi i ngjarjes. Së paku të kemi një analizë të kujdesëshme dhe të baraspeshuar të tyre. Libri “ Popull i tradhëtuar ”, u ofrua nga autori si hap i parë i mbarë.

Shaban Sinani

Në vënd të prologut

A mund të thuhet se urrejtja dhe dhuna e shekullit të 20-të, janë thjesht shëmbëllyre e thelbit tonë të pashmangshëm? Po qe se kjo nuk është e vërtetë, atëhere si shpiegohen fatkeqësitë që kanë pllakosur sot botën dhe si mund të krijojmë një koncept më të thellë dhe të aplikueshëm? Çfarë aftësish kemi për ta realizuar këtë? A është e mjaftueshme forca njerëzore apo mos vallë? ”

Glen Tinder

Vija politike që ndoqën politikanët shqiptarë gjatë periudhës 1991-1996 pati një fund tragjik, një fund të turpshëm. Në muajt shkurt-mars 1997, pushteti shqiptar për herë të parë në historinë moderne të shtetit shqiptar, vendosi gjendjen e jashtëzakonshme e pas kësaj, shteti shqiptar, pushoi së qeni. Elementët e tij bazë, që janë ushtria, policia dhe financa u shkatërruan plotësisht. Mbeti vetëm një pushtet i arnuar, i sakatosur, që u quajt qeveri e pajtimit kombëtar e cila kishte fuqi në Tiranë dhe përreth saj. Për të mbajtur rendin dhe qetësinë në Shqipëri, klasa politike shqiptare e pluralizmit e djathtë dhe e majtë, thirri në ndihmë forcat shumëkombëshe.

Janë shkruar me qindra analiza, janë dhënë me qindra opinione pse ndodhi një gjë e tillë. Janë bërë me qindra aluzione dhe supozime, që nga përzierja e fuqive të huaja dhe e shërbimeve të ndryshme sekrete, e rebelimit komunist, e mafies etj. Por opinionet dhe aluzionet janë të kota dhe nuk i japin përgjigje çështjes kryesore që shtrohet para çdo shqiptari. Ajo shtrohet në formën e dileme të madhe që qëndron pezull në ndërgjegjen e çdo shqiptari, në ndërgjegjen kombëtare: Edhe në kohën e Ahmet Zogut kishte rebelime, përzierje të shërbimeve të huaja, dhe në kohën e Enver Hoxhës kishte të tilla, por asnjëherë nuk u vu në pikëpyetje ekzistenca e shtetit shqiptar. Si shpiegohet që kjo ndodhi në kohën e “ demokracisë ”, në të cilën, sipas politikanëve shqiptarë nuk ka armiq? E dyta në gjithë historinë e shtetit shqiptar, gjëndja e jashtëzakonshme nuk u vendos as në kohën e monarkisë, as të komunizmit, por u vendos në kohën e demokracisë, kur gjithë propaganda europiane dhe botërore predikon krijimin e rendit të ri botëror dhe avantazhet e tij. Si shpiegohet një gjë e tillë? E treta: Populli shqiptar as në kohën e monarkisë e as në atë të komunizmit, nuk është ndodhur në pragun e luftës civile. Në pragun e kësaj lufte ai u ndodh vetëm në kohën e demokracisë. E katërta : Si shpiegohet që deri në datën 13 mars 1997, kur populli kryengritës ishte në këmbë dhe në llogore, numëri i të vrarëve ishte vetëm 27, ndërsa pas kësaj date kur frenat i morën në dorë politikanët, pra kur u krijua qeveria e ashtuquajtur e “ pajtimit kombëtar ”, numëri i të vrarëve arriti me mijra vetë ? Dhe, e fundit, në kohën e demokracisë, një popull i tërë ngrihet në revoltë kundër pushtetit të tij, duke kërkuar në fillim në rrugë paqësore dhe më vonë me mjete dhune dorëheqjen e këtij pushteti. Analiza dhe përgjigja shkencore e çështjeve të shtruar më lartë, do të jetë me interes të veçantë jo vetëm për shpiegimin shkencor të ngjarjeve që ndodhën në Shqipëri në pranverën 1997 por akoma me shume, ato do të jenë me interes për një rishikim tërësor të predikimeve dhe propagandës së bërë deri më sot ndaj të kaluarës së Shqipërisë, ndaj historisë së saj, ndaj të sotmes dhe veçanërisht ndaj së ardhmes së saj.

Atdhetarizëm apo kozmopolitizëm

Ngjarjet në Shqipëri në pranverën -1997, që nisën në jugun e vëndit dhe u përhapën shumë shpejt në të gjithë Shqipërinë, patën një jehonë të madhe në mbarë opinionin botëror dhe reperkusione të mëdha edhe në jetën politike dhe sociale të Shqipërisë.

Përballë këtyre ngjarjeve që morën formën e kryengritjes popullore, shteti “ demokratik ” shqiptar u shëmb shumë shpejt. U deshën revoltat popullore që morën shkas nga shëmbja e fondacioneve piramidale, u desh shpallja e gjëndjes së jashtëzakonshme nga ish-pushteti shqiptar, që institucionet themelore të shtetit të shëmbeshin plotësisht. U shpërbë ushtria “ demokratike ” që në shumicën e rasteve kaloi në anën e popullit kryengritës. U shpërbë policia që nuk pranoi të qëllonte mbi popullin. U shpërbë dhe pushoi së ekzistuari shërbimi informativ kombëtar. Partia demokratike u detyrua ta lëshojë pushtetin. Opozita ishte e paaftë dhe frikacake ta marrë atë. Frut i frikës së klasës politike nga revolta popullore ishte krijimi i qeverisë së koalicionit që tragjikisht u quajt “ »Qeveria e Pajtimit Kombëtar« ” dhe ftesa për të dislokuar në Shqipëri forcat shumëkombëshe, të cilat e shkelën Shqipërinë për herë të dytë pas 85 vjetësh. Ngjarjet që ndodhën në Shqipëri, janë bërë objekt i deklaratave, analizave, vëzhgimeve nga masa e gjërë e politikanëve shqiptarë dhe të huaj, të politologëve shqiptarë dhe të huaj, të publicistëve dhe mediave të shumëllojta televizive botërore. Por megjithse u shkruan me qindra dhe mijra artikuj dhe analiza, megjithse u dhanë me qindra deklaratat dhe komente televizive, në morinë e shkaqeve të dhëna për shperthimin e këtyre ngjarjeve, në hipotezat e politikanëve, mungon evidentimi i thelbit real të këtyre ngjarjeve. Me disa përjashtime ky thelb “ çuditërisht ” është anashkaluar. Vërtet politikanët dhe analistët shqiptarë dhe të huaj, nuk janë në gjëndje të zbulojnë thelbin e këtyre ngjarjeve? Vështirë të besohet. Për propagandistët fanatikë partiakë, është normale të mos depërtojnë në thelbin e ngjarjeve, por të mbrojnë interesat e partive. Por për shumicën e politikanëve dhe analistëve të huaj kjo nuk qëndron. Ata kanë qënë dhe janë në gjëndje ta zbulojnë thelbin e këtyre ngjarjeve, ata e kanë ditur dhe e dinë mirë se kush qëndron në themel të këtyre ngjarjeve. Arsyeja përse nuk e kanë thënë hapur dhe në mënyrë të plotë, ka rrënjë të thella që lidhen me historinë e Shqipërisë veçanërisht me të kaluarën e saj, që lidhen me kuptimin dhe interpretimin e nocioneve të tilla si liri dhe pavarsi kombëtare, dinjitet dhe sovranitet kombëtar.

Shkaqet e dukshme të ngjarjeve shqiptare

Dështimi i skemave piramidale

Ngjarjet në Shqipëri filluan pas shëmbjes së skemave piramidale si protesta dhe revolta paqësore, vazhduan si kryengritje e armatosur dhe perfunduan si anarki dhe kaos. Është një fakt i njohur se në këto skema piramidale të konsideruara nga klasa politike shqiptare në pushtet si mrekullia shqiptare, populli humbi rreth 1 miliard dollarë. Në kushtet ekonomike dhe sociale të Shqipërisë kjo ishte një humbje totale.

Mashtrimi i pushtetit

Përbën një realitet të pakundërshtueshëm për të gjithë opinionin publik shqiptar dhe të huaj se firmat piramidale që për më se dy vjet vepruan në Shqipëri, kishin përkrahjen dhe mbrojtjen e klasës politike shqiptare, veçanërisht të asaj që ishte në pushtet. Midis pushtetit dhe firmave të fajdeve ishte vendosur një marrëveshje nga e cila kishin fitim të dy palët. Piramida shtetërore kishte përfitimin sepse ekzistenca e këtyre firmave, përqindjet e larta të parave që ato jepnin, ishte mjeti dhe propaganda më e mirë, për përfitime politike dhe për ruajtjen e pushtetit. Mardhënie të tilla midis pushtetit dhe popullit ishin më tepër se komode. Është kjo arsyeja që shumë qeveritarë shqiptarë deklarorin hapur se këto lloj mardhëniesh ishin mrekullia shqiptare e ndërtimit të kapitalizmit, se paratë që merrnin shqiptarët nga firmat ishin nga paratë më të pastra në botë. Sipas tyre, ky ishte kapitalizmi popullor shqiptar. Nga ana tjetër dhe për bosët e

firmave të fajdeve, ky qëndrim i pushtetit shqiptar ishte shumë i dobishëm. Në kompensim të përkrahjes që i bënin qeverisë dhe klasës politike shqiptare, në kompensim të parave që derdhnin veçanërisht për fushatat elektorale dhe xhepat e qeveritarëve, ata ishin të lirë të vepronin si të donin. Pushteti shqiptar dhe administrata e tij ishin mbulesa e tyre. Dhe mbulesa e shtetit është një koracë shume e fortë.

Brënda kësaj tabloje u vendosën marrdhëniet ekonomike midis pushtetit shqiptar dhe popullit në vitet 1993-1997.

Parantezë

Në ndriçimin më të plotë të enigmës shqiptare lypset evidentuar dhe një elemnt i rëndësishëm i jetës politike dhe sociale në Shqipëri, për periudhën 1993-997. Marrdhëniet midis pushtetit shqiptar dhe popullit gjatë kësaj periudhe, nuk u vendosën mbi bazën e ligjeve që ka çdo shoqëri njerezore, pavarisist nga forma e qeverisjes se saj. Ligje u miratuan me qindra por ato ishin vetëm fasada. Ato realisht mbeten forma e shoqerise shqiptare, propaganda e saj e jashtme, por jo thelbi i saj. Marrdhëniet reale u ndërtuan mbi bazën e kodeve zakonore, veçanërisht mbi bazën e institucionit të besës.

Pushteti shqiptar që veprroi pas vitit 1992 në Shqipëri nuk është gjë tjetër veçse një pushtet i ngritur mbi bazën e kodeve zakonore të para 400 vjetëve. Jo vetëm opinioni shqiptar por dhe ai i huaj njuh mirë argumentimin që lidërshipi shqiptar i bëri kanunit të Lekë Dugagjinit gjatë fushatës për hartimin e projektkushtetutës. Thelbi i këtij argumentim ishte se Kanuni i Lekë Dugagjinit ishte shumë herë më përparimtar se teoria e Karl Marksit. Gati në të gjitha fjalimet e tij të kësaj periudhe, lidërshipi shqiptar, fjalinë e fundit e kishte standarte: “ Kam ardhur të kërkoj besën tuaj ”. Pavarisist nga neveria që ngjalli ky argumentim në qarqet politike dhe gazetareske të huaja, duhet thënë se në Shqipëri, alergjia e njerëzve ndaj komunizmit, solli si pasojë që në shtresa të tëra njerezish të pranohej si i vërtetë. Për më tepër, duke qenë i veshur dhe me “ vellon ” e nacionalizmit pasi Leka ishte shqiptar, ndërsa Marks i ishte gjerman.

Ndikimin më të madh të institucionit të besës në psikologjinë e shqiptarëve e vërejmë më dukshëm në marrdhëniet ekonomike midis shtetit dhe popullit në Shqipëri. Për shumë prej nesh sot është e habitshme, e pabesueshme se si qindra mijra njerëz depozitonin me mijra dollarë, franga apo marka në këto fondacione fajdesh në shkëmbim të një emri në listë apo të një fature të thjeshtë. Por çudia dhe pabesueshmëria ”, bëhen të pavlefshme përballë thenies së njerëzve: “ Këto fondacione nuk falimentojnë pasi ato i mbron shteti, i mbron presidenti, ata na kanë dhënë besën ” Fjala e qeverisë e dhënë nëpërmjet deklaratave televizive apo fjalimeve të ndryshme, pamjet televizive që tregonin bosët e firmave piramidale krah për krah me qeveritarët ishin një konfirmim i “ besës ” së pushtetit.

Ndërsa gjatë muajit Janar 1997, ishte qeveria dhe lidërshipi kryesor i pushtetit që filluan t’i mbyllnin këto fondacione, që filluan të deklaronin se nuk dinin gjë për veprimtarinë e tyre, që nuk do t’i kompensonin njerezit që kishin humbur paratë. Për qindra mijëra shqiptarë nga Veriu në Jug, ky qëndrim i qeverisë dhe lidërshipit të saj, nuk ishte gjë tjetër veçse prerje në besë. Qeveritarët shqiptarë vepruan me kanun në marrdhëniet me popullin e tyre, por dhe me kanun do ta merrnin përgjigjen. Në bazë të kanunit, besëprerja shpaguehet me dënim kapital.

Indiferenca e opozitës

Gjatë viteve 1992-1996, për shkak të luftës së egër për pushtet, opozita shqiptare ka qënë

nën një represion të egër të pushtetit shqiptar, duke filluar qe nga ndjekjet dhe persekutimet e duke mbaruar tek burgosjet. Ndaj fondacioneve piramidale, opozita teorikisht mbajti një qëndrim indiferent, ajo dhe teoricienet e saj te fushave te ekonomise apo te prognozave politike, asnjehere nuk reagan ndaj predikimeve dhe propagandes se pushtetit mbi nevojën e këtyre fondacioneve si thelbi i kapitalizmit popullor shqiptar. Heshtja e teoricienëve të opozitës ishte ndihmë e madhe për pushtetin shqiptar. Ndërsa praktikisht i mbështeti ato. Dyzimi i saj përbën një ndër shkaqet e zëmërimit popullor. Vetëm gjatë muajit dhjetor 1996 dhe më konkretisht në 24 dhjetor 1996, Departamenti ekonomik i Partisë Socialiste, mori qëndrim kundër fondacioneve, duke kërkuar shndërrimin e tyre në banka private. Ishte shumë vonë ! Në këtë kohë kishin filluar të flisnin pak nga pak dhe segmente të veçanta të pushtetit. Ishte koha kur institucionet e fuqishme ndërkombëtare si Fondi Monetar, kishin kërkuar me forcë ndërhyrjen e qeverisë për ndalimin e veprimtarisë së tyre.

Përse nuk mbajti qëndrim opozita kundër fondacioneve, dhe veçanërisht kundër mashtrimit të pushtetit? Pergjigjja e kesaj pyetjeje nuk eshte e thjeshtë, ajo ka te bëjë me seriozitetin e nje force politike qe kerkon te marrre pushtetin dhe ta mbaje ate, ka te beje me largepamesine e kesaj force politike. Nuk e dinte rrezikshmërinë e tyre opozita apo e mbajti qendrimin e saj për qëllime pushtetore.? Indiferenca e opozitës shqiptare nuk ka bazë tjetër veçse naivitetin politik dhe mungesën e një strategjie të saktë në luftën politike. Gjatë periudhës 1992-1996, vija politike e saj ishte një vijë politike e lëkundur, pa një bosht të qartë. Në qëndrimin ndaj fondacioneve piramidale, kjo lëkundje u shfaq lakuriq. Nuk është vijë e qartë politike gjykimi se dalja kundër fondacioneve do të ndikonte në zvogëlimin e elektoratit, do te ulte perqindjen ne zgjedhje dhe do të shkaktonte zëmërimin e bosëve të këtyre fondacioneve. Të lësh një popull të mashtrohet nga mashtrimi i pushtetit me pretekstin se do të me humbasë elektorati, do të thotë që për qëllime pushtetore indirekt të jesh pjesmarrës në mashtrim. Por përsëri nuk është qëndrim i pjekur politik gjykimi se dhe po të ndodhë gjë përgjegjësinë do ta mbajë qeveria. Të përdorësh humbjen popullore përsëri për efekte pushtetore, kjo nuk është gjë tjetër veçse cinizëm. Në politikë gjykohet me largpamësi, politika e ditës është e vlefshme vetëm brënda ditës apo brënda muajit. Zgjedhja e indiferencës zyrtare ndaj pabesisë së pushtetit, as kundër, por as dhe pro, ishte një ndër faktorët kryesorë që opozita shqiptare, u ndodh krejtësisht e papergatitur kur filluan revoltat popullore. Politikën gjatë muajit Janar dhe Shkurt 1997 nuk e drejtoi as pushteti dhe as opozita. Në të kundërtën, e drejtoi zëmërimi popullor nëpër rrugët dhe sheshet e Shqipërisë. Në ngjarjet e janar-shkurtit 1997 klasa politike shqiptare mori atë që meritonte; mashtrimi i pushtetit mori zëmërimin e egër popullor, indiferenca e opozitës mori indiferencën e popullit.

#### Pragmatizmi euroamerikan

Pragmatizmi euroamerikan ishte dhe mbetet një ndër shkaqet e jashtme të ngjarjeve në Shqipëri. Mardheniet e popullit shqiptar me pushtetin kanë qënë me kohë të njohura për politikën euroamerikane. Veprimtaria e dyshimtë e fondacioneve piramidale, po ashtu ka qënë shumë e njohur nga institucionet ndërkombëtare monetare dhe shërbimet sekrete të këtyre shteteve. Ka qënë shumë e njohur situata politike dhe sociale në Shqipëri nga të gjitha kancelaritë euro-amerikane. Por të gjitha këto dukuri, nuk i penguan këto kancelari të deklarorin se Shqipëria ishte një ndër vendet më të përparuara në fushën e demokracisë, kur demokracia ne Shqiperi ishte thjesht nje proklamate dhe jo nje realitet,

te deklarorin se pushteti shqiptar ishte nga me demokratiket ne te gjitha vendet e Evropes Lindore, kur ai nuk ishte i tille. Shkaqet janë të njohura. Për politologet dhe analistet serioze, ato janë dy: Shqipëria u kishte rezistuar këtyre kancelarive për më se 40 vjet, ajo nuk e kishte pranuar ndarjen ndërkombëtare të punës të predikuar në fillim nga sovjetikët e më vonë nga të tjerët. Në marrdhëniet ndërkombëtare siç pohonte me të drejtë Andre Fonteni “ Ajo kërkon zërin e saj, të barabartë me atë të tre të mëdhenjve ” Pas viteve 1990, fshehur pas fjalës demokraci dhe pas gjëndjes së rëndë ekonomike të shqiptarëve, kishte ardhur koha e hakmarrjes së të madhit ndaj rebelimit të të voglit. Realizimi i kësaj hakmarrjeje nga vetë shqiptarët ishte mëse komod për kancelaritë euroamerikane. Dhe shkaku i dytë ishte stabiliteti i paqes në Ballkan. Pushteti shqiptar që u vendos me përkrahjen dhe bekimin e kancelarive euroamerikane mori persipër në politikën e jashtme të bëhej garant i paqes në Kosovë. Sa kohë që vazhdonte lufta në Bosnjë, klasa politike në Shqipëri, me teoritë e saj të hapsirave demokratike, të heqjes dorë nga kërkesat maksimaliste, arriti që gjëndjen në Kosovë ta mbante larg shpërthimit të zëmërimit popullor. Klasa politike shqiptare në Prishtinë dha një ndihmesë të madhe. Ajo në vënd të merrej realisht me fatin e Kosovës pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, më shumë u kujdes për “ shkatërrimin ” e komunizmit në Shqipëri. Kjo ishte një ndihmë e madhe për kancelaritë euroamerikane.

Ndryshimi i qëndrimit euroamerikan filloi pas farsës tragjike të 26 Majit 1996. Në fillim Amerika dhe institucionet ndërkombëtare nisën akuzat ndaj pushtetit shqiptar. Reagimi euro-amerikan dhe në këtë rast ishte pragmatist dhe asgjë tjetër. Me veprimet dhe qëndrimet e tij pushteti shqiptar e vuri në vështirësi të madhe propagandën euroamerikane mbi rendin demokratik dhe demokracinë. Kishte vite të tëra që kjo propagandë, para popullit shqiptar e kishte paraqitur demokracinë si burimin e të gjitha të mirave materiale dhe shpirtërore. Por në qoftë se kjo parrullë pati efektet e saj në fillimet e pluralizmit, me kalimin e kohës ajo u zvetënuar, dhe transformuar në sytë e popullit shqiptar në të kundërtën e saj. Shumica dërrmuese e shqiptarëve në fundin e 1996-ës, pyetjes se “ Kush është më i keq se sistemi i kaluar ”, kishin filluar t’i përgjigjeshin masivisht : “ Kjo që po jetojmë sot ”. Prandaj dhe kjo propagandë për të shpëtuar nga diskreditimi predikimet e saj, u kujtua të mbante qëndrim ndaj atyre që për vite të tëra i kishte përkëdhelur. Propaganda dhe politika euroamerikane nuk denoi manipulimin e farsës shqiptare të 26 Majit, por u detyrua të dënonte brutalitetin dhe vrazhdësinë e këtij manipulimi, egërsinë e tij. Në këtë moment pushteti shqiptar dhe lidërshipi i saj, bënë gabimin e tyre fatal për të ruajtur pushtetin. Ata deshën të kundërshtonin atë që i kishte sjellë në pushtet dhe që i mbante me bukë, duke i propaganduar si kampionë të demokracisë kur nuk ishin gje tjetër vetem se varremihesit e saj. Ky ishte fundi i këtij pushteti. Qeveritë kukulla mbahen ne secilin vend te botes nga te huajt vetem per interesa te tyre. Ky konkluzion është i vlefshëm për të gjitha kohët dhe për të gjitha sistemet, për ideologjitë e djathta dhe për ideologjitë e majta. I vetmi ndryshim qëndron tek “ kostumi ” politik. Kur këta të huaj zëmërohen, atëhere ky është fundi i këtyre qeverive. Opinioni botëror dhe atij shqiptar filluan t’i bëheshin të njohura pak nga pak lidhjet reale të pushtetit shqiptar me fondacionet mafioze, filluan t’i tregoheshin dhe denoncoheshin shkeljet e rënda ndaj lirive të individit, deri atje sa në fillim të muajit janar 1997, me të dhëna të shërbimeve sekrete perëndimore, pushteti shqiptar në një gazetë të madhe perëndimore, u cilësua si “ qeveri gangsterësh ”.

## Retrospektive

Opozita juridike dhe reale në Shqipëri  
(Zvicër, Fillimshkurti 1997)

Aktualisht në pushtet në Shqipëri është Partia Demokratike. Prej koalicionit me të janë larguar republikanët e Sabri Godos dhe Partia e Ballit Kombëtar. Ka mbetur vetëm një parti shumë e vogël, e quajtur Bashkimi Social-demokrat si partnere qeveritare. Ndërsa në opozitë ndodhen shumë parti. Ato fillojnë nga Partia Socialiste, SocialDemokrate, Aleanca Demokratike dhe mbarojnë tek Partia Demokratike e Djathtë e Kalakulës dhe monarkistët e Durollarit. Spektri i opozitës në Shqipëri është shumë i gjërë. Ai përfshin në vetvehte të majtën dhe të djathtë bashkë. Në rregullat e lojës së pluralizmit kjo lloj opozite ku bashkohen të djathtët dhe të majtët bashkë, përbën një rast unik të panjohur në lojën politike që zhvillohet në vëndet pluraliste. Megjithatë ky përbën një problem më vehte për tu trajtuar dhe nuk është objekt i kësaj analize. Problemi që duam të analizojmë dhe të trajtojmë është: Kush është opozita reale në Shqipëri për pushtetin aktual dhe kush është opozita juridike?

Opozita juridike në Shqipëri

Partia Socialiste, SocialDemokrate, Aleanca Demokratike, Partia Demokratike e së Djathtës, republikanët, ballistët etj, të grumbulluar në Forumin për demokraci, paraqiten në opinionin publik të brëndshëm dhe të jashtëm si opozita reale e pushtetit aktual shqiptar.

Por a është vërtetë kështu? A përbëjnë partitë e mësipërme opozitën reale në shqipëri për pushtetin aktual. Arsyetimi i zhveshur nga propaganda partiake dhe nga mburrjet, arsyetimi i bërë mbi bazën e analizës reale të situatës në Shqipëri të nxjerr në një konkluzion tjetër. Partitë e mësipërme janë vërtetë opozitë e pushtetit aktual në Shqipëri. Por ato nuk janë opozitë reale, janë vetëm opozitë juridike. Konkluzioni i mësipërm del nga vetë realiteti shqiptar. Për një pushtet kushdo qoftë ky opozitë reale është vetëm ajo opozitë që i rrezikon seriozisht pushtetin. Dhe aktualisht pushteti i Partisë Demokratike në Shqipëri është shumë i rrezikuar. Por jo nga partitë e mësipërme. Aleanca midis këtyre partive ishte dhe në 26 Maj 1996, ishte dhe në 20 Tetor 1996, por megjithatë pushteti aktual nuk e ndjente vehtën të rrezikuar sa tani. Për më tepër pushteti shqiptar disa partive që tani paraqiten si opozitare si republikanët dhe ballistët në 26 Maj 1996 u bëri dhe disa të mira, iu la në fazën e balotazhit disa vënde në parlament. Ndërsa politikanët e tjerë të opozitës si Kurt Kolën, Arben Imamin, Skënder Gjinushin etj i rrahu me kërbaç dhe kurrkush nuk u shqetësua as nga opinionin i jashtëm e as nga opinionin i brëndshëm. Partitë e mësipërme, për pushtetin aktual shqiptar nuk janë të rrezikshme, sepse ato janë vetëm opozitë juridike. Fuqia e opozitës juridike e shumta është të bëjë konferenca shtypi, të bëjë deklarata, të bëjë artikuj nëpër gazeta dhe protesta pranë organizmave ndërkombetare që përfundojnë në rastin më fatlum me ndonjë rezolutë dhe asgjë tjetër.

Opozita reale në Shqipëri

Megjithatë pushteti shqiptar ka aktualisht përballë edhe një opozitë të fuqishme reale. Kësaj ai i trëmbet shumë. Prandaj është e para herë brënda këtyre pesë vjetëve që Partisë Demokratike po i rrezikohet seriozisht pushteti. Po cila është opozita reale e pushtetit aktual shqiptar? Ajo është brënda dhe jashtë Shqipërisë.

Populli i mashtruar

Kjo është opozita reale e brëndëshme. Falimentimi i fondacioneve piramidale dhe



varfërimi i tejskajshëm, e nxorri popullin në Shqipëri për herë të parë si opozitë reale ndaj pushtetit të Partisë Demokratike. Kjo është një opozitë shumë e rrezikshme. Sepse një popull i lënë pa para, i zhgënjyer dhe i mashtruar, nuk i njeh rregullat e lojës së pluralizmit politik. Ai nuk bën konferenca shtypi, deklarata dhe protesta. Ngjarjet e ndodhura në Berat, Lushnjë, Fier, Korçë, Vlorë, Memaliaj etj e provojnë më së miri këtë. Kjo opozitë nuk ka ngjyra politike. Në të janë të gjithë që nga socialistët deri tek demokratët, sepse të gjithë një ditë të bukur mbetën në mjerim të plotë, pa para dhe një pjesë edhe pa shtëpi. Mjerimi dhe zhgënjimi nuk njeh ngjyra partie. Ai është i njëjtë dhe ka vetëm një emër: Mjerim dhe varfëri. Rrezikshmëria e kësaj opozite qëndron në faktin se ajo duke qënë jashtë ngjyrave partiake, është e vështirë të futet në kornizat e pambukta të lojës politike të pluralizmit politik, ajo nuk kënaqet me një kolltuk qeveritar siç mund të kënaqet ndonjë parti, ajo nuk kënaqet as me ndonjë rezolutë të Këshillit të Evropës apo Parlamentit Europian siç mund të kënaqet opozita juridike në Shqipëri. Për opozitën reale në Shqipëri këto nuk mjaftojnë. Kërkesa e saj është e thjeshtë por është jetike: “ Ti qeveri më mashtrove, kur më the se këto fondacione janë mrekullia shqiptare, se paratë e tyre janë paratë më të pastra dhe unë të besova. Prandaj gjithë kursimet e mija, të djemve të mij në Itali, Greqi apo Gjermani, i investova në to, shita shtëpitë dhe paratë e tyre i futa në këto fondacione. Ndërsa një ditë shpalle falimentimin e tyre dhe mua më le në mjerim të plotë. Prandaj dua paratë e mija sepse më ke prerë në besë ”. Pushteti shqiptar që e ka bërë shumë të njohur kanunin e Lekë Dugagjinit e di shumë mirë se cili është çmimi i besëprerjes.

Është një kërkesë e rrezikshme, që nuk realizohet me kolltuqe qeveritare, as me premtime politikanësh, që nuk qetësohet me fjalët e bukura të Leni Fisherit apo Zhak Santerit, por është dhe një kërkesë që nuk trëmbet nga policia dhe kërbaci. Zhgënjimi dhe mashtrimi janë më të fortë nga shkopi i policit.

Prandaj pushteti aktual shqiptar është shumë i shqetësuar dhe i tronditur. Sepse tani ai e di se ndodhet para opozitës reale, e cila deri në 31 Dhjetor ishte aleate e tij duke i dhënë dhe fitoren e 20 Tetorit 1996.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës-opozita reale e jashtme

Edhe kjo është një opozitë reale shumë e rrezikshme për pushtetin shqiptar. Gjatë këtyre pesë vjeteve, pushteti shqiptar ka patur nga organizma të ndryshme ndërkombëtarë që nga Këshilli i Evropës, OSBe-ja, Federata e Helsinikit etj, dhjetra rezoluta e protesta të ndryshme. Por nuk është shqetësuar shumë. Organizmat e mësipërme kanë qënë opozita juridike e jashtme e pushtetit, fuqia e të cilave ka qënë deri në bërjen e rezolutave. Ndërsa pas 26 Majit 1996 e deri tani, Shtetet e Bashkuara të Amerikës përbëjnë opozitën reale të jashtme të pushtetit shqiptar. Pushteti shqiptar këtë e di mirë prandaj dhe është i shqetësuar. Për atë është e qartë se në rastin konkret nuk ka të bëjë me ndonjë organizëm ndërkombëtar që ka në dorë vetëm çelsat e kashtës, por ka të bëjë me NJESHIN e botës nga i cili trëmben dhe i binden edhe fuqi më të mëdha dhe më të zhvilluara se Shqipëria. Është interesante, por është shumë reale, se dhe në rastin e SH.B.A-ve kemi të bëjmë me një kalim nga aleati më i ngushtë i jashtëm në opozitën reale me të egër të jashtme. Dhe kjo ndodhi pas 26 Majit të 1996-ës, kur nga Amerika, pushtetit shqiptar i erdhën kritika të ashpra lidhur me zgjedhjet parlamentare. I tronditur dhe i çoroditur nga krahura dhe manipulimi kolosal i 26 Majit, pushteti shqiptar, ndaj kritikave të Amerikës reagoi njësoj si ndaj OSBe-së, duke bërë gabimin e saj më fatal. Njëri pas tjetrit disa politikanë amerikanë duke filluar që nga Timothe Wirthi e duke mbaruar tek Eliot Engell gati sa

nuk u shpallën persona të padëshirueshëm nga pushteti shqiptar, u shpeshuan kritikak ndaj vetjakiteteve amerikane nga organet e shtypit proqeveritar. Që nga ky moment Amerika u shndërrua në opozitën reale të jashtme të pushtetit shqiptar. Po cili është qëllimi i kësaj opozite reale të jashtme? Shtypi dhe politikanët e partive politike shqiptare, i mëshojnë faktit se Amerika është e shqetësuar për fatin e demokracisë në Shqipëri. Gjykim i gabuar ose propagandistik. Amerika u shndërrua në opozitë reale ndaj pushtetit shqiptar, jo për faktin se është e merakosur për fatin e demokracisë në Shqipëri. Mjafton të përmëndim se para 26 Majit në Shqipëri janë shkelur me dhjetra herë demokracia dhe të drejtat e njeriut. Rasti më flagrant ishte arrestimi i Fatos Nanos dhe dënimi i tij. Megjithatë, Amerika nuk reagoi ndonjëherë, për të mos thënë se ishte ambasadori amerikan Raierson në Korçë ai që ideoi fushatën e makartizmit në Shqipëri, kur deklaroi se pas zgjedhjeve të 22 Marsit, socialistëve u uronte të mbeteshin pa punë. Ndërsa pas 26 Majit pushteti shqiptar dhe lidërshipi i tij “ u rebeluan ” ndaj Amerikës, u bëne të “ pa bindur ” dhe filluan të kërkojnë aleatë të tjerë në Evropë. Dhe për ti ndëshkuar “ rebelët ”, ajo ka dalë në vënd të parë në kritikak ndaj pushtetit shqiptar, duke ju kërkuar dhe vëndeve evropiane të mbajnë qëndrimin e saj. Me këtë qëndrim, Amerika do që tju japë dhe një mësim dhe partive të tjera politike në Shqipëri, i cili mund të përmblihet në shprehjen: “ Unë që ju sjell në pushtet, unë mund dhe tju heq përsëri, kur tregoheni të pabindur dhe rebelë ”.

Eshtë një opozitë e pamëshirshme në thelb, po të kemi parasysh dhe filozofinë e saj, pragmatizmin amerikan. Por që në aparencë vepron me maturi dhe shumë diplomaci, me flamurin e mbrojtjes së demokracisë në Shqipëri.

Kush do të fitojë

Kjo është tabloja e jetës politike dhe sociale. Por natyrshëm shtrohet pyetja: Kush do të fitojë? Do të fitojë opozita juridike apo përsëri pushteti aktual do të dalë fitues? Opozitës juridike në Shqipëri i duhet të shndërrojë në aleatë të saj opozitën reale, popullin e mashtruar dhe Amerikën. Detyrë e vështirë përpara partive politike shqiptare të grumbulluara në Forumin për Demokraci. Atyre u duhet tja mbushin mëndjen popullit se po të vinë ata në pushtet, situata do të ndryshojë. Në kushtet e zhgënjimit të tanishëm kjo detyrë kërkon mëncuri të madhe nga opozita juridike shqiptare. Në radhë të parë kërkon jo vetëm solidarizim, por përpunimin e një alternative më të mirë se të tanishmen. Kjo alternativë përmban dy elementë të rëndësishëm. E para një program politik social dhe ekonomik për të kapërcyer situatën e tanishme. Përpamja e shprehur nga disa drejtues të forumit se ne nuk luftojmë për pushtet, prandaj nuk kemi përpunuar alternativë, nuk qëndron. Brënda forumit janë disa parti politike dhe të gjithë e dinë se ato luftojnë për pushtet, që në mënyrë të natyrshme kërkon dhe një alternativë që ti mbushë mëndjen popullit për tu shkuar pas dhe Amerikës për të siguruar mbështetjen e saj. E dyta: Opozitës juridike i duhet dhe lideri i saj. Pushteti aktual e ka një lider dhe ky është Berisha. Ndërsa opozita akoma nuk ka një lider të saj. Fatos Nano është në burg. Atëhere kush është lideri i opozitës, Ceka, Mejdani, Kalakula, Gjiniushi, Kola? Të gjithë bashkë nuk mund të jenë. Lideri është një. Opozitës i duhet t’i zgjidhe në mënyrë urgjente këto dy detyra, për tu bërë e besueshme tek opozita reale, populli dhe Amerika. Por nga ana tjetër dhe pushteti aktual shqiptar megjithë goditjen që ka marrë nga opozita reale, veçanërisht nga populli i zhgënjyer, nuk po jepet. Ai po përdor të gjitha format për të rezistuar. Por e ka tepër të vështirë. I duhet të bindë një popull të tërë, cili këtë radhë

nuk gënjehet me premtime, por kërkon paratë e humbura. Por pushteti nuk ka para për buxhetin e tij dhe jo ti japë popullit milionat dhe miliardat e dollarëve të humbura. Por i duhet të bindë dhe Amerikën e cila përsëri nuk bindet me premtime.

Kush do të fitojë? Do të ketë ndonjë fitues në këtë luftë tepër të vështirë politike, apo do të ketë vetëm humbës?

Akull, kujdes rreshqitje

Edhe kjo mund të ndodhë. Mund të ndodhë që pushteti aktual të dështojë në përpjekjet e tij për të qetësuar popullin dhe neutralizuar Amerikën. Kjo ka shumë mundësi të ndodhë. Por mund të ndodhe që dhe opozita juridike të mos hartojë dot një alternativë të besueshme dhe të mos e bëjë dot me vehte popullin dhe Amerikën. Kjo do ta futë vëndin në një rrugë pa krye. Në një rast të tillë anarkia dhe kaosi do të bëjnë ligjin duke i hapur rrugën destabilizimit të vëndit. Ky do të ishte varianti më tragjik, por në luftën politike duhet parashikohen të gjitha variantet. Prandaj ka nevojë të hiqet dorë nga slloganet bajate: luftojmë për demokracinë etj si këto. Duke llogaritur dhe variantin më tragjik, parulla më e saktë do të ishte: Luftë për ruajtjen e Shqipërisë. Masat qindra mijëshe të popullit janë vërtet të zhgënjyer nga pushteti aktual, janë akoma dyshues nga opozita juridike e grumbulluar në Forumin për demokraci, por kanë akoma besim tek politikanët shqiptarë. Parullat e hedhura gjatë demonstratave në Vlorë, e konfirmojnë më së miri një gjë të tillë.

Interpretimet e ngjarjeve

Ngjarjet e pranverës 1997 ne Shqipëri, u bënë objekt interpretimi i shumllojshëm nga shqiptarë dhe të huaj. Tipari i përbashkët i këtyre interpretimeve janë interesat e atyre që i kanë bërë dhe jo analiza objektive e ngjarjeve. Në interpretimet e këtyre ngjarjeve duhen dalluar tre faza kryesore : Faza e parë që nis me fillimin e ngjarjeve deri në krijimin e qeverisë së pajtimit kombëtar. Faza e dytë që nis me qeverinë e pajtimit kombëtar dhe mbaron me zgjedhjet e 29 qeshorit. Dhe faza e tretë që nis pas zgjedhjeve të 29 qershorit dhe në vazhdim. Më konkretisht interpretimet e ngjarjeve që ndodhën në Shqipëri na japin një tablo të tillë :

a-Interpretimi i ish-pushtetit shqiptar

Në interpretimet e tij, ish-pushteti shqiptar kaloi nëpër disa faza. Fillimisht ai nuk u thellua shumë në përmbajtjen dhe thelbin e revoltave, por i trajtoi ato si pakënaqësi popullore ndaj mbylljes së skemave piramidale. Nisur nga kjo logjikë për interesa pragmatiste ai e spostoi qëndrën e zëmërimit popullor sa më larg Tiranës, duke mbyllur fondacionet që qëndrën e tyre e kishin në Vlorë, Berat dhe Lushnjë dhe duke ruajtur Vefën e cila ndodhej në Tiranë. Llogaria e pushtetit ishte : “ Sa më larg kryeqytetit, sa më larg syve të opinionit ndërkombëtar, sa më larg udheheqjes së opozitës, aq më mirë do të jetë për t’i fashitur këto revolta dhe këtë pakënaqësi popullore, aq më e lehtë do të jetë për t’i neutralizuar ato ”. Siç do ta tregonin më vonë ngjarjet dhe zhvillimi i tyre, ky ishte gabimi i parë fatal i ish-pushtetit shqiptar. Publicistja e njohur zvicerane Veronikë Paskie, në një nga shkrimet e saj të botuar në gazetën 24 Orë në Zvicër qysh në fillim të muajit shkurt 1997, nënvizon se spostimi i qëndrës së zëmërimit në Jug dhe veçanërisht në Vlorë që historikisht ka qënë qëndra e patriotizmit, do t’i kushtojë shumë shtrenjtë Berishës. Në fillimet e revoltave, ish-pushteti shqiptar ndoqi metodën e kulaçit dhe të kërbaçit. Në propagandën e shtetarëve shqiptarë, predikohej se populli ka të drejtë të demonstrojë. Veçanërisht pas ngjarjeve të dhunshme në Berat dhe Lushnjë, lidërshipi shqiptar i pranonte manifestimet paqësore nëpër fjalimet dhe konferencat e tij të shtypit. Ndërsa

nga ana tjetër policia sekrete filloi arrestimet dhe frikësimet e të gjithë atyre që dyshoheshin se kishin organizuar protestat. Precipitimi i ngjarjeve, veçanërisht në qytetin e Vlorës, shënoi dhe evoluimin e gjuhës dhe propagandës zyrtare. Demonstratat në Vlorë treguan se nuk i besonte më kush propagandën dhe deklaratat e pushtetarëve. Në këto demonstrata, as më shumë dhe as më pak kërkohej denimi i atyre që i kishin prerë në besë. Pas këtij momenti propaganda zyrtare filloi të fliste me gjuhën e forcës kundër atyre që demonstroi duke kërkuar paratë e tyre. Propaganda zyrtare filloi të bëjë përpjekjet e para duke dezinformuar opinionin e brendshëm dhe të jashtëm. Në shkrime gazetash dhe komentesh televizive, filluan të bëheshin aluzione dhe lidhje midis demonstruesve shqiptarë dhe atyre serbë. Propaganda zyrtare filloi të luajë me kartën e patriotizmit. Por ky ishte një patriotizëm falso me një kartë të çjerrë, prandaj nuk pati sukses dhe asnjë peshë emocionale në popull. Përpjekjeve të pushtetit për t'i shtypur me forcat e policisë sekrete manifestimet paqësore, populli në Vlorë ju përgjigj me rrëmbimin e armëve. Pas kësaj qeveria shqiptare vuri në përdorim armën e saj të fundit, ajo shpalli gjëndjen e jashtëzakonshme duke mobilizuar ushtrinë dhe forcat speciale, për të shtypur revoltat. Ndërsa në fushën e propagandës, popullin e armatosur filloi ta quajë “ banditë të lidhur me disa agjensi zbulimi që duan të përmbysin me dhunë rendin kushtetues ”. Por as kjo armë e propagandës dhe e interpretimit të ngjarjeve, nuk pati sukses. Pas Vlorës, brënda një jave, populli u ngrit dhe u armatos gati në 14 qytete të Shqipërisë së jugut dhe Shqipërisë së mesme, ndërsa çdo rajon i Shqipërisë ishte gati në shpërthim. Përballe kësaj situatë, propaganda zyrtare për të shpëtuar çfarë mund të shpëtonte, e ndihmuar dhe nga disa segmente të politikës dhe propagandës në Kosovë, përdori gurin e fundit; hodhi në eter tezën makabre se revoltat e jugut kishin synim përçarjen e Shqipërisë dhe aneksimin e Jugut Greqisë. Me këtë lloj propagande që përsëri nuk pati sukses populli e pa qartë se deri ku shkon lakmia e luftës për pushtet, deri në coptimin e vëndit.

Parantezë

“ Revolucioni leninist ” dhe kryengritja shqiptare

Nga ish-pushteti shqiptar dhe propaganda e tij, teza mbi kryengritjen shqiptare si “ revolucion leninist ”, është teza më e përhapur dhe më trajtuar. Mbas krijimit të qeverisë së pajtimit kombëtar, kur ish-pushteti shqiptar filloi ta marrë vehten, në propagandën e tij, në librat dhe pamfletet e shkruara, kryengritja popullore shqiptare, klasifikohet si “ rebelim komunist, si revolucion leninist ”. Një klasifikim i tillë ka patur dhe ka disa synime. Së pari : me një klasifikim të tillë, synohet që kryengritja popullore shqiptare të paraqitet si një lëvizje klasore dhe ideologjike, si një tentativë për kthimin prapa të historisë e ngjashme me lëvizjen e Haxhi Qamilit në vitet 1913. Së dyti : një klasifikim i tillë synon t'i heqë kryengritjes shqiptare mbështetjen brënda dhe jashtë vëndit. Së treti : Duke njohur negacionin që ka në qarqe të ndryshme brënda, por më shumë jashtë Shqipërisë teoria leniniste e revolucionit, u synua dhe vazhdon të synohet diskreditimi i thelbit të kryengritjes popullore shqiptare.

Së katërti : Legalizmi i kryengritjes shqiptare si revolucion leninist, pra si marrje e pushtetit me dhunë, presupozon dhe lëniën hapur të rrugës për tu rikthyer në pushtet me anë të dhunës.

Por me gjithë synimet e qarta, propaganda dhe analiza e ish-pushtetit nuk i qëndron të vërtetës historike. Janë disa arsye dhe argumente që e dëshmojnë këtë. Së pari : Nuk ka asnjë dyshim se revolta e armatosur e marsit 1997 ishte një kryengritje popullore. Por jo çdo kryengritje popullore është e barabartë me një revolucion leninist. Pohimi se

kryengritja shqiptare ishte revolucion leninist shpreh ose paditurinë dhe nivelin e ulët intelektual të predikuesve të kësaj teze, ose urrejtjen ndaj popullit dhe aspiratave të tij. Shoqëria njerëzore qysh nga krijimi i saj dhe deri në daljen e teorisë marksiste njihet me dhjetra dhe qindra revolucione dhe kryengritje popullore bashkë me interpretimet e tyre përkatëse teorike. Kryengritja e Spartakut në skllavopronari kundër Romës, kryengritjet e fshatarëve kundër feudalizmit që nga Zhakeria e Jan Husi deri tek lufta fshatare në Gjermani, që nga Robin Hudi e deri tek kryengritja e Parisit e 1948-ës etj, të gjitha këto nuk kanë qënë gjë tjetër veçse protesta të popujve kundër tiranisë dhe mjerimit ekonomik dhe shpirtëror.

Së dyti : Në pushtet në Shqipëri nuk erdhën drejtuesit dhe udhëheqësit e kryengritjes, por ish-opozita shqiptare që u mbështet nga diplomacia euroamerikane si e keqja më e vogël.

Së treti : Pretendimi për përsëritjen e ngjarjeve historike nuk është gjë tjetër veçse një aventurizëm politik, që kur i lë fushë të lirë shndërrohet vetëm në terrorizëm.

Njohja e historisë botërore dhe analiza e ngjarjeve historike të ndodhura në Shqipëri në harkun kohor 1991-1997, dëshmojnë qartë vërtetësinë e pohimit të mësipërm. Në 1991-1992, populli shqiptar u ngrit në demonstrata dhe manifestime jo se i tha ky apo ai lider i Partisë Demokratike, por sepse ishte masivisht i pakënaqur nga pushteti i mëparshëm. Partia demokratike vetëm sa e shfrytëzoi këtë pakënaqësi. Populli shqiptar në shkurtmarsin e vitit 1997, u ngrit në demonstrata, manifestime dhe deri në kryengritje, nga pakënaqësia masive ndaj pushtetit të atëhershëm. Partia socialiste dhe partitë e tjera të ish-opozitës vetëm sa e shfrytëzuan këtë pakënaqësi për të ardhur në pushtet duke u mbështetur dhe nga faktori ndërkombëtar, i cili ndërsa e dëshironte rrëzimin e Berishës, nuk e dëshironte ardhjen në pushtet të forcave kryengritëse. Këto janë ngjarje historike që në themel të tyre kanë shkaqe më të thella se sa lufta e politikanëve për pushtet. Të përpiqesh t'i përsëritësh këto ngjarje historike për të ardhur në pushtet, do të thotë të biesh në aventurizëm. Çdo ngjarje historike e përsëritur sipas dëshirave të politikanit, nuk ka qënë gjë tjetër veçse karikaturë e vetë ngjarjes reale historike.

b-Interpretimi i opozitës

Ashtu si pushteti, dhe opozita në fillim nuk ishte në gjëndje t'i parashikonte ngjarjet që do të ndodhnin dhe gjërësinë e tyre. Ajo u gjënd e papërgatitur kur ato shpërthyen. Prandaj në fillim opozita operoi me parullat e manifestuesve. Mitingu i zhvilluar në 26 janar 1997 në Tiranë ku thelbi i parullave ishin parullat e popullit dhe jo te opozites politike shqiptare, vertetonte qarte pohimin e mesiperm mbi spontanitetin e veprimeve të opozites në fillimet e revoltës popullore. Me kalimin e kohës opozita shqiptare e grumbulluar në Forumin për demokraci, hartoi kërkesat politike që rrithnin nga protestat popullore. Në interpretimin e opozitës shqiptare, duke marrë parasysh nuancat e partive politike që bënin pjesë në opozitë dhe interesat e shtimit të elektoratit, ngjarjet në Shqipëri u interpretuan si refleksi i zëmërimit popullor ndaj qeverisë, si dështim i vijës politike dhe ekonomike të saj. Ndërsa protestuesit u cilësuan si popull i zhgënjyer dhe i mashtruar nga pushteti. Këtë qëndrim e mbajtën jo vetëm partitë politike shqiptare të bllokut të majtë të përfaqësuar nga partia socialiste, por dhe shumë parti të bllokut të djathtë, veçanërisht nga e djathta e bashkuar. Në anën e popullit të revoltuar kaloi dhe shoqata e të përndjekurve politike e kryesuar nga Kurt Kola. Në momentin e rrëmbimit të armëve nga ana e popullit për tu mbrojtur nga egërsia e pushtetit, opozita shqiptare në fillim i hutua dhe hezitoi në qëndrimin e saj. Është kjo arsyeja që ato nxituan ta nënshkruajnë atë që u quajt marrëveshja e 9 Marsit, duke marrë pjesë në qeverinë e

koalicionit. Pas këtij momenti, opozita shqiptare, tashme bashkëpjesmarrëse në qeveri, fillon interpretimin e ngjarjeve sipas interesave të partive të ndryshme politike, me synim kryesor kush e kush të fitonte më shumë elektorat.

Përse socialistët nuk ishin drejtues të kryengritjes shqiptare

Propaganda e ish-pushtetit dhe një pjesë e propagandës ndërkombëtare i mëshon tezës se drejtuesit e qeverisë së pas 29 Qershorit 1997 dhe partitë e tyre përkatëse, kanë qënë frymëzueset dhe drejtueset e kryengritjes shqiptare. Pa hyrë në arsytet që serviren për një pohim të tillë, analiza e realitetit të shpërthimit të kryengritjes shqiptare si dhe analiza e programeve dhe veprimtarisë konkrete të këtyre partive e hedh poshtë pohimin e propagandës së ish-pushtetit shqiptar. Partia socialiste dhe partitë e tjera aleate të saj, as objektivisht, por as dhe praktikisht nuk mund të ishin frymëzueset dhe drejtueset e kryengritjes shqiptare.

Së pari : Partia socialiste dhe aleatët e saj, nuk janë gjë tjetër veçse parti të lindura dhe rritura në kushtet e një klime pluraliste, ku parësore në luftën politike për të fituar pushtetin janë dialogu dhe zgjedhjet parlamentare. Të gjitha këto parti e kanë të përjashtuar nga programet e tyre marrjen e pushtetit me rrugë të armatosur. Synimi i tyre qysh nga lindja në vitet 1991 e më vonë ka qënë rregullimi i “ kozmetikës ” së tyre për tu pranuar në gjirin e partive homologe në Evropën perëndimore.

Së dyti : Qëllimi i partisë socialiste dhe aleatëve të saj të koalicionit qeveritar, është diametralisht i kundërt me qëllimin e kryengritjes. Nëqoftëse thelbi i luftës politike të ish-opozitës është lufta për pushtet, thelbi i kryengritjes popullore është dinjiteti kombëtar. Kryengritja popullore glorifikoi “ Shën Njeriun ” e përdhosur gjatë viteve, ish-opozita glorifikoi “ Shën Pushtetin ”.

Së treti : Kryengritja popullore shpërtheu jashtë skemave dhe kombinacioneve politike të klasës politike shqiptare dhe politikës amerikane, prandaj dhe u shtyp në mënyrë “ demokratike ” prej tyre. Ndërsa ish-opozita ishte pjesë e këtyre kombinacioneve politike. Së katërti : Kryengritja popullore shqiptare ishte pasoja e një qeverisjeje të keqe, pasoja e një pushteti që ndërsa ishte legjitim me votat që mori në 1992-shin, u shndrrua ilegjitim me qëndrimin që mbajti ndaj popullit të cilit i përkiste. Ndërsa klasa politike e ish-opozitës si e tërë klasa politike shqiptare, ishte pasoja e artificialitetit dhe kombinacioneve politike të vitit 1991.

Së pesti : Analiza e veprimtarisë së ish-opozitës gjatë viteve 1992-1996, qëndrimet e saj politike dhe sociale ndaj dëshmojnë për paaftësinë e saj për të marrë pushtetin me vota të lira, jo më për të marrë pushtetin me anë të kryengritjes. Parashtrimi i mëposhtëm do të sjellë fakte dhe dukuri në favor të tezës së mësipërme :

Retrospektivë

Në politikë fiton ai që bën më pak gabime

Nëndor 1996

Kriza politike shqiptare, aq e përfolur brënda dhe jashtë vëndit, që zuri fill pas 26 Majit, me zgjedhjet e 20 tetorit duket se shënoi fundin e saj. Partia demokratike i fitoi zgjedhjet lokale. Fitoren e saj dhe humbjen e tyre e pranoi dhe opozita dhe në veçanti Partia socialiste. Me këtë fitore partia demokratike ja doli mbanë të rregullojë imazhin e saj të krijuar në botë pas zgjedhjeve të përfolura të 26 Majit. Natyrshëm që pas kësaj do ketë komente, analiza, opinione dhe gjykime të ndryshme. Brënda këtij kuadri janë dhe opinionet e mëposhtme të cilat dhe për shkak të largësisë janë të ftohta dhe frut i analizës

së fakteve dhe ndodhive të luftës politike në Shqipëri në mes partive të ndryshme politike, jashtë ndjenjave dhe paragjykimeve partiake.

Pse humbi opozita dhe në veçanti partia socialiste, pse fitoi partia demokratike, cilët ishin faktorët e brëndshëm dhe faktorët e jashtëm. Kush përgatiti më mirë humbjen, kush diti që humbjen ta kthejë në fitore dhe kush nuk e ruajti dot fitoren dhe në fund çfarë mund të thuhet për të ardhmen e luftës politike në Shqipëri

Kuptimi naiv dhe kuptimi real mbi demokracinë

Pa dyshim se fjala demokraci, ka qënë fjala më e lakuar gjatë periudhës së pluralizmit në Shqipëri. Por analiza reale dhe e ftohtë e luftës politike në Shqipëri, na evidenton në këtë çështje të madhe dy qëndrime diametralisht të kundërta: Kuptimin naiv dhe kuptimin real mbi demokracinë. Të parin më shumë e kemi ndeshur në radhët e opozitës dhe të një pjese intelektualësh, ndërsa të dytin e ndeshim më shumë në radhët e Partisë Demokratike. Le ta bëjmë më konkret pohimin tonë: Me qindra intelektualë në fillimet e pluralizmit u rreshtuan në ndihmë të Partisë Demokratike. Me shkrimet e tyre, me qëndrimin e tyre ata dhanë një ndihmesë të madhe për marrjen e pushtetit nga partia demokratike. Më vonë ishin pikërisht këta që filluan të thonë se “ kjo nuk është demokraci ” Kjo është luftë për pushtet ”. Ishte një kuptim naiv për demokracinë. Të luftosh për pushtet, ky është qëllimi kryesor i fjalës demokraci në çdo vënd të botës. Të njëjtin kuptim naiv për demokracinë e ndeshim tek opozita dhe veçanërisht tek veprimtaria e partisë socialiste. Mjaftojnë dy shëmbuj për ta ilustruar pohimin tonë. Shëmbulli i parë është arrestimi i Fatos Nanos. Nano u bë shumë i rrezikshëm për pushtetin me mitingjet e tij anë e mbanë Shqipërisë, prandaj ai duhej eliminuar nga skena politike. Në pamundësi për tu eliminuar për bindje politike se tashmë ekzistonte pluralizmi, ai u eliminua për shpërdorim të pozitës zyrtare gjatë kohës që kishte qënë. Shumë antarë dhe simpatizantë të Partisë socialiste në atë kohë dhe më vonë u shprehën “ Sa të poshtë, pse demokraci është kjo? ”. Këtij kuptimi tejet naiv, mund t’i japim vetëm një përgjigje: “ Po more zotërinj, kjo është vërtet demokraci. Pse çfarë prisnit ju që ta linim Nanon të ngrinte Shqipërinë në këmbë dhe t’i thoshnim Hajde shoku Nano merre pushtetin. Naivë të shkretë. Ne duam ta ruajmë pushtetin se për atë luftuam. Ju po ti jini të zotë, na e merrni, po mos prisni se do tju a japim ”.

Shëmbulli dytë është periudha pas referendumit për projekt kushtetutën. Partia socialiste dhe partitë e tjera me “ Jo ”-në e elektoratit të tyre, i shkaktuan një humbje të rëndë Partisë Demokratike. Por vetëm kaq. Pas kësaj partia socialiste ra në gjumë me mendimin naiv se “ tani u pa kush ka më shumë elektorat. Kjo tani është e qartë dhe për botën dhe për pushtetin. Tani jemi në demokraci dhe neve na takon pushteti ” Dhe vetëm kaq e asgjë tjetër. Ndërsa partia demokratike filloi të marrë masa si tja hidhte kundërshtarit, si tja shvleftësonte fitore, si ta ruante pushtetin. Dhe vimë kështu tek shëmbulli i tretë i naivitetit fatal për demokracinë nga ana e partisë socialiste. Ligji mbi gjenocidin. Ligji për gjenocidin i miratuar nga parlamenti shqiptar ishte veprimi më i zgjuar politik i Partisë Demokratike për të ruajtur pushtetin, pas dështimit me projekt-kushtetutën. Në fakt veprimi i këtij ligji asaj ja dha dhe njëherë pushtetin. Ndërsa miratimi i këtij ligji nga partia socialiste ishte shëmbulli më i plotë i naivitetit politik të një partie që kërkon të marrë pushtetin. Atë ditë që socialistët ngritën dorën për të thënë se në Shqipërinë e kaluar ishte kryer gjenocid, realisht ata po atë ditë ngritën dorën për ta lënë dhe katër vjet të tjera pushtetin në duart e Partisë Demokratike. Për këtë fajin nuk e ka partia

demokratike, fajin e kanë vetë socialistët. Përse? Dhe njeriu më i thjeshtë në Shqipëri e kuptoi se miratimi i këtij ligji nuk synonte ish klasën drejtuese në Shqipëri, goditjen dhe burgosjen e saj. Ata ishin të parrezikshëm për pushtetin. Për të eliminuar ata nuk kishte nevojë për ligj parlamenti, sepse kishte klauzola ligji aktual sa të duash. Ligji për gjenocidin u mendua, u projektua dhe u hartua si armë për të penguar partinë socialiste që kërkonte pushtetin, që pas referendumit e quante vehten fituese. Dhe deputetët socialistë me naivitete ja ngulën vehtes së tyre. Pastaj filluan të ankoheshin. Por ishte vonë, tepër vonë. Ankesat e tyre kishin dhe kanë vetëm një përgjigje: “Pse ankoheni kot shokë socialistë. Ju vetë ishit dakord që në Shqipëri është ushtruar gjenocid. Me që vetë ishit dakord atëherë duhet të dini dhe tjetrën se gjenocidin e kanë ushtruar njerëz konkretë. Se cilët janë këta, këtë e di ligji dhe komisioni i të shtatëve. Nuk është faji ynë që ju ratë vetë me të dyja këmbët brënda”

Teoria e NJESHIT dhe demokracia është një problem tjetër që e bën më të prekshëm kuptimin naiv dhe real mbi demokracinë. Partia demokratike duke mbajtur vëndin e parë në përdorimin e fjalës demokraci, ruajti dhe zbatoi në praktikën e saj atë që në literaturën politike quhet teoria e njëshit. Në disa raste ajo përjashtoi nga udhëheqja apo radhët e saj të gjithë elementët që nuk ishin dakord me këtë teori, që nuk ishin dakord me Berishën si Njëshi i partisë. Rasti i parë ishin mocionistët që më vonë krijuan partinë e Aleancës demokratike, rasti i dytë ishte Kalakula që krijoi partinë e djathtë demokratike dhe rasti i tretë ishte shkarkimi i Selamit si kryetar partie që nuk krijoi asgjë. Veprime të tilla nga ana e opozitës janë konsideruar si veprime autoritare të Berishës. Në këtë konkluzion opozitën e ka çuar kuptimi naiv mbi demokracinë. Këto nuk janë veprime autoritare, por veprime të drejta dhe reale. Në gjithë botën perëndimore ndodh kështu. Në thelb kështu vepron dhe Shiraku, që pasi fitoi zgjedhjet nuk i dha asnjë post shokëve të tij që nuk e kishin përkrahur si Baladurit, Leotardit etj, por ua dha postet atyre që e përkrahën në fushatën për president si Zhypesë me shokë. Kështu veproi para ca kohësh dhe Kostas Simitisi në Greqi, pasi vdiq Papandreu. Teoria e njëshit është teori demokratike. Shikoni O.K.B-në. Aty ka demokraci për të gjithë shtetet të flasin dhe të thonë çfarë të duan, pra ka votë. Por kur vjen puna për të marrë vendimet, aty ka dhe veto. Veton e kanë pesë shtete, Amerika, Kina, Franca, Anglia dhe Rusia. Njëra nga këto të mos dojë të miratohet një vendim që e kanë propozuar 189 shtete, vë veton dhe vendimi nuk miratohet. Megjithatë është kështu nuk ka dalë ndonjë nga opozita shqiptare të thotë që O.K.B-ja është është organizatë autoritare.

Në të kundërtën e Partisë Demokratike, opozita veproi ndryshe, ajo u perpoq të drejtonte dhe udhëhiqte pa teorinë e Njëshit, por në mënyrë kolegjinale. Pas burgosjes së Nanos, Partinë socialiste i drejtonin pesë “njësia”, katër nënkryetare dhe një sekretar i përgjithshëm. Përgjigja e Hajdaragës para dy vjetësh gjatë një interviste, se “Berisha me burgosjen e Nanos me shumë e ka forcuar partinë socialiste sepse tani jemi katër Nano që drejtojmë”, më shumë se realitet ishte një tollumbace propagandistike, pa vlera reale. Mungesa e Njëshit, partinë socialiste e dëmtoi shumë. Përpjekjet e Nanos për ta riparuar këtë gabim në pragun e Kongresit në muajin gusht, jo vetëm që ishin të vonuara, por për më tepër nga që në parti ishin krijuar tani pesë Njësia, të cilët kërkonin të bëheshin Njësia real, shkaktuan përshtjellim në radhët e saj duke dëmtuar imazhin në sytë e elektoratit dhe të opinionit ndërkombëtar.

Politika, morali dhe diletantizmi i opozitës

Periudha 1992-1996, dëshmon se opozita shqiptare dhe veçanërisht Partia socialiste në



veprimtarinë e saj më shumë ka bërë moral se sa politikë, më shumë ka ecur me norma morale se sa me norma politike. Kjo ka qënë fatale për të. Morali dhe normat morale janë të vlefshme në jetën shoqërore dhe në lëndën e etikës. Ndërsa kur vjen puna në veprimtarinë politike dhe luftën për pushtet, ato nuk kanë vlerë, bile janë shumë të dëmshme.

Le ta argumentojmë mendimin tonë: Qysh në fillimet e saj, Partia demokratike i kushtoi kujdes rreshtimit në anën e saj të sa më shumë njerëzve dhe shtresave të ndryshme njerëzish. Kriteri i saj nuk ishte karakteri i këtyre shtresave, nuk ishin veset apo virtytet e karakterit të tyre, por besnikëria ndaj vijës së partisë. Këtë kriter ajo e vazhdoi dhe më vonë duke e sofistikuar në terminologji, por duke e ruajtur në thelb. Kjo asaj i dha mundësi jo vetëm ta ruajë por dhe ta fitojë përsëri pushtetin. Kur Ajzenahuerit, këshilltarët e tij i thanë se Somoza ishte i dobët si karakter, ai u përgjigj: “ E di se Somoza është i poshtër, por megjithatë përkraheni se është i yni ”. Është një mësim i madh për një parti politike që do të rrijë në pushtet apo që kërkon të marrë pushtetin. Këtë mësim të madh, Partia demokratike e ka zbatuar shumë më mirë se opozita. Njerëz me vese të ndryshme në karakter, por besnikë ndaj saj, ajo nuk i largoi, por i mbajti pranë, i përdori sa ju deshën dhe kur ju deshën dhe kur u bënë të pavlefshëm i kaloi në hije, natyrisht duke ju kujtuar se ua dinte veset dhe bëmat e tyre. Në shtypin e opozitës mjaft herë është folur dhe shkruar për veset e këtyre njerezve. Diletantizëm politik i opozitës. Ky diletantizëm ka vetëm një përgjigje: “ Po mor zotni, mirë thua ti, por filani është i yni politikisht dhe na duhet. Pushteti nuk ruhet dhe drejtohet me norma morale, por me norma politike. Ju që kërkonti të vini në pushtet me norma të moralit më mirë shkoni në shkolla dhe jipni lëndën e moralit dhe të etikës ”. Ndërsa opozita dhe veçanërisht Partia socialiste më shumë u interesua për pastërtinë morale të radhëve të saj se sa për besnikërinë ndaj saj. Në fillimet e saj, ndikoi në këtë qëndrim dhe sulmi i Partisë Demokratike ndaj saj. Por nëqoftëse në fillim ishte e justifikueshme, më vonë ky qëndrim i saj nuk ishte gjë tjetër veçse diletantizëm politik, që asaj i kushtoi shtrenjtë. Duke pranuar si kriter veset dhe virtytet e karakterit, për të ruajtur gjoja pastërtinë e radhëve të saj, Partia socialiste bëri një gabim fatal. Në vënd të vinte vetullat, ajo nxorri sytë. Në fushën e moralit ekzistojnë terma të tillë si i poshtër, matrapaz, i pandershëm, hipokrit, servil etj. Por në fushën e politikës këto terma kanë emra të tjerë si i shkathët, manovrues, trim, i zhdërvjellët, elastik etj. Le të zbresim në një terren akoma më konkret duke konkretizuar disa dukuri të luftës politike

Problemi i parë: Problemi i pluralizmit politik. Partia socialiste u përpoq te aplikonte pluralizmin politik në organizmin e saj, ashtu siç thuhet nëper libra dhe traktate politike. Ndërsa partia demokratike u tregua më e shkathët. Pluralizmin ajo e zbatoi vetëm në funksion të marrjes së pushtetit. Për Partinë demokratike, pluralizëm që nuk të ndihmon të vish në pushtet nuk ka vlerë. Prandaj ajo në funksion të ruajtjes dhe të marrjes së pushtetit ruajti vetëm fjalën Pluralizëm, duke i bashkangjitur sipas momentit terma të tilla, si pluralizëm krahinor, pluralizëm karakteresh, pluralizëm regjional etj. Është një fakt tashmë i njohur nga të gjithë se në fillimet e pushtetit kreu i Partisë Demokratike u mbështet shumë tek një masë e madhe komunistësh nga Veriu të cilët i duheshin për ruajtjen dhe forcimin e pozitave të tij. Askush nuk u interesua apo shqetësua se pse ndonjëri prej tyre dhe sot në shtëpinë e tij mban fotografinë e Enver Hoxhës. Rëndësi kishte ruajtja dhe forcimi i pushtetit. Dhe ky ishte një veprim shumë i mënçur politikisht. Problemi i dytë është problemi i biografive. Dhe në këtë çështje Partia socialiste veproi

me norma morali, ndërsa partia demokratike me norma politike. Partia socialiste është ndoshta partia që më shumë se të gjitha partitë e tjera niset nga biografia e së kaluarës. Kjo bëri që në funksion të krijimit të një partie të pastër, në funksion të asaj se mos na kritikojnë dhe na thonë se “ ju kini njerëz me biografi komuniste apo simpatizantë të komunizmit ”, ajo largoi nga vetja shtresa të tëra njerëzish që e njinin mirë luftën politike. Por mbajti në radhët e saj ish-komuniste të konvertuar në socialiste që njihnin vetëm librat dhe pragun e shtëpive të tyre, pra që në të kaluarën “ as e kishin ndezur, as e kishin shuar ”. Ata ishin me biografi të mirë, sepse nuk ishin ndeshur me njeri, por politikisht ishin diletantë dhe naive. Të kundërtën bëri partia demokratike. Kushdo që ishte me programin e saj ajo e pranoi pavarsisht nga biografia komuniste, monarkiste apo balliste. Ky ishte një veprim i zgjuar politik, që i mbuluar me nevojën e luftës kundër komunizmit dhe socializmit i dha asaj përparësi në luftën politike dhe mjetet e zhvillimit të kësaj lufte.

Vijë e lëkundur politike

Gjatë periudhës 1992-1996, vija politike e opozitës me disa përjashtime të vogla u tregua vijë e lëkundur pa një bosht të qëndrueshëm. Tek partia social demokrate, partia e Aleancës demokratike dhe partia demokratike e së djathtës, kjo lëkundje e vijës së tyre politike është shumë e hapur dhe e qartë. Ato e nisën vijën e tyre politike si aleate dhe bashkëpjesmarrëse me Partinë demokratike dhe e perfunduan si kundërshtarë të saj dhe në aleancë me Partinë socialiste. Por lëkundjeve në vijën politike nuk u shpëtoi as Partia socialiste. Për ta ilustruar më mirë mendimin tonë po sjellim dy shembuj nga praktika e partisë socialiste.

E para qëndrimi i saj ndaj çështjes kombëtare. Në thelb qëndrimi i partisë socialiste ndaj çështjes kombëtare është i njëjtë me qëndrimin e Partisë Demokratike. Në këtë çështje që të dyja janë parti kozmopolite. Por ndërsa partia demokratike ka qënë më e hapur në këtë çështje, partia socialiste është treguar më e lëkundur. Heqja dorë nga kërkesat maksimale, hapsirat demokratike mbarë kombëtare, pranimi i autonomisë së 1974 etj, janë terma që partia demokratike i ka thënë hapur dhe me gojën e liderëve kryesorë të saj. Ndërsa partia socialiste megjithëse është dakord me këto terma, nuk ka bërë prononcime të hapura. Për më tepër gazeta e saj Zëri i Popullit në mjaft raste ka botuar shkrime që janë në kundërshtim me vetë programin e partisë në çështjen kombëtare. Shkrimet e shumta të marrë nga organi i Lëvizjes Popullore të Kosovës, Zëri i Kosovës, apo shkrime të ndryshme të Rexhep Qosjes, kanë gjetur vënd dhe jehonë në Zërin e Popullit. Dihet preteksti se për çfarë arsye janë botuar. Për të thënë se Berisha dhe partia demokratike nuk e përkrahin republikën e Kosovës, prandaj shqiptarët e Kosovës nuk duhet ta përkrahin atë. Sepse realisht socialistët nuk kanë asgjë të përbashkët në program me pikpamjet e L.P.K-së dhe të Rexhep Qosjes. Por socialistët dhe ata që i botuan këto shkrime, harruan se për çfarë arsye i ka përdorur Berisha shkrimet e botuara në Zërin e Popullit. I ka përdorur për t'i thënë opinionit të jashtëm se socialistët janë përkrahësit dhe mbështetësit e forcave radikale në Kosovë, që janë kundër zgjidhjeve që ofron bashkësia ndërkombëtare. Pra dhe në këtë rast, arma e përdorur kundër Berishës dhe Partisë Demokratike u kthye si bumerang në kurrizin e Partisë socialiste.

Një problem tjetër që shpreh lëkundjen e vijës politike të Partisë socialiste, ka qënë qëndrimi ndaj pushtetit në Shqipëri. Me oshilacione të ndryshme socialistet herë kanë thënë se në Shqipëri është instaluar diktatura, herë se në horizont po duken shënjat e diktaturës, herë se demokracia në Shqipëri është vetëm në letër, herë se në Shqipëri

mbretëron revanshizmi, megjithse vetë pohojnë në parlament se në Shqipëri ka patur genocid etj. Gazetarëve apo njerëzve që nuk luftojnë për pushtet u lejohen oshilacione të tilla. Por një partie politike dhe për më tepër partisë kryesore të opozitës nuk i lejohen këto lëkundje, përkundrazi e dëmtojnë. Ja përse. Nëqoftëse thua se është instaluar diktatura dhe këtë e ke të argumentuar atëhere duhet të punosh ta përgatitësh elektoratin tënd të përballojë diktaturën. Përndryshe dëmton vehten. Të pohosh nëpër mitingje se në Shqipëri është instaluar diktatura dhe të shkosh në zgjedhje qetë qetë e pastaj një ditë më vonë të ankohesh se më rrahën apo më kërcënuan, kjo tregon lëkundje të madhe politike dhe ka vetëm një përgjigje: “ Pse ankohesh që të rrahën apo të dhunuan. Ti vetë ke thënë që në Shqipëri ka diktaturë. A ke thënë? Po kam thënë. Atëhere duhet ta dish se diktatura të rreh dhe të kërcënon, ashtu siç të burgos. Nëqoftëse e kishe seriozisht propagandën tënde, përse u fute në zgjedhje. Të thuash nga një anë se ligji për zgjedhjet është antidemokratik dhe nga ana tjetër përsëri thua se dhe më këtë ligj ne do t’i fitojmë zgjedhjet pasi kompjuteri i Partisë ka treguar se nga 115 zona, 82 janë të garantuara, se në mëngjesin e 27 Majit ne do t’i themi Berishës: Mirëmengjes opozitë, kjo nuk është logjikë politike serioze, por megallomani diletantësh politikë ”.

Reformim i Partisë apo parti klubesh

Një nga paradokset më të mëdha të partisë socialiste që do të mbetet në historinë e pluralizmit shqiptar, është koncepti i saj i të ashtuquajturit reformim i partisë. Udhëheqja e P.S.-së ka folur shpesh për reformimin, por më me forcë e paraqiti konceptin e saj për reformimin në pragkongresin e saj. Kush është njohur me tezat e udheheqësve socialiste për reformimin, kush gjykon me mendje të kthjellët dhe që ka pak njohuri fillestare në politike, nuk e ka të vështirë që ta zbërthejë thelbin e vërtetë të të ashtuquajturit reformim. Me konceptet e udheheqjes socialiste i ashtuquajturi reformim nuk është gjë tjetër veçse shndërrim i partisë socialiste nga parti që lufton për pushtet, nga parti popullore në parti klubesh, e ngjashme me partinë e Aleancës demokratike dhe partinë social-Demokrate. Ja argumentat në favor të pohimit të mësipërm:

E para: Në kuadrin e reformimit, udheheqja e kësaj partie, hodhi tezën e largimit dhe distancimit nga “ enveristët. ”

E dyta: Më vonë ajo hodhi tezën e distancimit dhe të largimit të “ ramizistëve ”.

Me mënyrën e propagandimit të këtyre tezave, ky veprim do të thoshte se partia socialiste nuk i donte votat e këtyre shtresave që ajo i emërtoi si enveriste dhe ramiziste. Bukur! Po çfarë mbeti dhe kush mbeti në partinë socialiste, cila ishte baza e saj? Logjika e thjeshtë formale të thotë se nuk mbeti kurkush. Me konceptin e saj të reformimit, udheheqja e kësaj partie duhet të presë që të rriten ata që kanë lindur pas 1991-shit, të bëhen 18 vjeç që t’i pranojë në radhët e saj, pasi vetëm ata nuk do të jenë as enveristë, as ramizistë. Të gjithë tjerët në Shqipëri janë të lidhur në një mënyrë apo në një tjetër me enverizmin dhe ramizizmin pasi ato ishin ideologji zyrtare të Shqipërisë në të kaluarën. Dhe në Shqipëri të gjithë ata që marrin pjesë në votime janë produkt i Shqipërisë së kaluar, ideologjisë politikës, i shkollës, edukimit dhe kulturës së saj.

Pra nga reformimi i programit u kaluan në reformimin e individit.

Lind Pyetja? Pse e bëri këtë udheheqja e Partisë socialiste? Nuk është e aftë? Nuk di të gjykojë politikisht? Nuk e ka të qartë se me këtë veprim përfundimisht u shndërrua në parti klubesh dhe diskutimesh bajate? Apo ishte lufta e karrikeve dhe e posteve ajo që shpiku këtë lloj reformimi? Vështirë t’i përgjigjesh me saktësi kësaj pyetjeje, por të gjitha janë nga pak. Por një jë është shumë e sigurtë. Me konceptin e saj të reformimit,

udheheqja e partisë socialiste e shndrroi partinë nga parti popullore që lufton për pushtet në parti ideologjike që merret vetëm me propagandë dhe që nuk është e aftë për asgjë tjetër. Për çdo parti politike në çdo vënd pluralist, vota asnjëherë nuk ka patur dhe nuk ka ngjyrë. Ajo nuk është as shirakiste, as baladuriste as zhospeniste, as koliste as saliste, as enveriste, as ramiziste, as socialiste, as demokratiste. Ajo është thjeshtë votë, që preferon këtë apo atë program si më të saktë për realizimin e interesave individuale, apo përafërsisht më të saktë. Vetëm kaq dhe asgjë tjetër. Ndërsa për “teoricienët” socialiste na dalka se vota paska ngjyrë politike dhe ideologjike. Me këtë “zbulim” ata me të vërtetë meritojnë të hyjnë në librin e Ginisit. Dhe njeriu më i rëndomët në Shqipëri i di se reformimi i një partie qëndron në programin që ajo harton dhe në alternativat që ajo jep për zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë.

Dhe cili ishte rezultati i parë i këtij “reformimi”? Shtresat e njerëzve prej qindra mijra vetësh qëndruan indiferentë në votimet e 20 Tetorit. Dhe juridikisht partia socialiste u shndrrua me rezultatin që arriti, në një parti klubesh dhe ideologjike. Megjithatë një pjesë e udhëheqjes së saj tani ka me se të ngushëllohet: “Të paktën tani u reformuam, shpëtuam nga ata enveristë dhe ramizistë dhe ...rroftë reformimi. Do presim sa të rriten vogëlushat 3-4 vjeçarë dhe pastaj do marrim pushtetin. Vonë do të jetë, por të paktën ata nuk do të jenë as enveristë as ramizistë. Do jenë safi socialistë!!!”

Dy enigma të mëdha të luftës politike

Lufta politike midis pushtetit dhe opozitës, brënda harkut kohor të katër vjetëve, ka dy enigma të mëdha të ndodhura fare pranë njëra tjetrës në distancë kohore, që i përkasin njëra Partisë Demokratike dhe tjetra Partisë socialiste. Megjithse ato i kanë rrezikuar seriozisht pozitat dhe reputacionin e partive përkatëse, janë kaluar në heshtje apo me komente sipërfaqësore. Le t’i analizojmë konkretisht

Enigma e parë: 28 Maj 1996. Ngjarja është e njohur. Opozita vendos të demonstrojë në sheshin Skënderbej kundër dhunës dhe parregullsive në zgjedhje. Forcat e rendit ndërhyjnë dhe shpërndajnë demonstruesit në sytë e vëzhguesve ndërkombëtare me egërsi të madhe. Është veprimi më i trashë politik i Partisë Demokratike gjatë katër vjetëve, veprim që vetëm rastësia e shpetoi nga humbja e pushtetit. Perse? Një ditë pas zgjedhjeve, megjithë tërheqjen e opozitës nga zgjedhjet, megjithë konstatimet e bëra nga vëzhguesit e huaj, ata nuk e vinin në dyshim legjitimitetin e zgjedhjeve. “Opozita do të demonstrojë se nuk është dakord. Po mirë, le të demonstrojë. Po do dalin me qindra mijra njerëz. Po mirë le të dalin, le të bërtasin sa të duan. Njeriu kur bërtet lehtësohet. Do bërtasin dy orë dhe pastaj do ikin në shtëpi. “Dikush mund të thotë se po të grumbulloheshin me qindra mijra njerëz nuk dihej se çfarë do bëhej. Asgjë nuk do bëhej. Nëqoftëse demonstruesit do drejtoheshin institucioneve qeveritare, ata do të akuzoheshin për dhunim të rendit kushtetues dhe do të harrohej dhuna, manipulimet dhe parregullsitë e zgjedhjeve. Opinioni do të merrej me opozitën. Shëmbulli i Armenisë pas 4 muajsh, kur ndodhi një situatë analoge si në Shqipëri e vërteton këtë. Një ditë pas zgjedhjeve, opozita armene duke e akuzuar pushtetin për dhunë dhe manipulim në zgjedhje, duke patur dhe përkrahjen e vëzhguesve ndërkombëtare, doli me rreth 100 mijë vetë dhe demonstroi në rrugët e Erevanit. Pushteti nuk e pengoi, vetëm e vëzhgonte. Kur krerët e opozitës, të irrituar hynë në godinën e parlamentit, atëherë Presidenti armen Petrosian i akuzoi për tentim për grusht shteti dhe i dha urdhër ushtrisë për të ndërhyrë. Dhe brënda një ditë u harruan dhuna dhe parregullsitë gjatë zgjedhjeve, sepse pas kësaj ndodhie vëzhguesit e

huaj mbështetën Petrosianin dhe u përmënd vetëm tentativa për grusht shteti e opozitës. Ndërsa pushteti në Shqipëri me veprimin fatal që bëri ktheu dhe ata vëzhgues të lëkundur me opozitën, duke u dhënë material gazetarëve të huaj te mbushin faqet e gazetave për muaj të tërë. Megjithatë është shumë interesant se Partia Demokratike në Shqipëri, këtë veprim e ka kaluar shumë lehtë brënda vehtes së saj. Sikur të ishte një veprim i thjeshtë, ndërsa ai ishte një veprim që po e përsëris vetëm rastësia bëri që të mos humbiste pushteti.

Enigma e dytë: Pragkongresi i Partisë socialiste. Dhe kjo ngjarje dihet nga të gjithë. Kryetari i partisë, Nano nga burgu dërgon një mocion në të cilin kërkon që udhëheqja e lartë e partisë t'i nënshtrohej votëbesimit si dhe thellimin e reformimit të partisë. Në thelb mocioni i Nanos kishte të bënte me zbatimin e katër kushteve të vëna nga bashkësia ndërkombëtare. Kjo është shumë e qartë. Amerika dhe fuqitë e mëdha të Perëndimit e kërkonin këtë reformim për ta mbështetur Partinë socialiste. Nano e kapi dritën jeshile të tyre. Por një gjë ngelet enigmë e madhe; Pse u bë gjithë ajo zhurmë nga një pjesë e udhëheqjes së lartë të partisë, pse u bënë gjithë ato insinuata. Mocioni vinte nga burgu dhe ishte shkruar me gardianin tek koka. Ishte shumë e natyrshme që kuptimi i tij real, të merrej duke lexuar midis rreshtave. Në fakt ndodhi e kundërta. Ai u lexua dhe interpretua në pamje të parë, sipas interesave mesquine dhe karrieriste të një pjesë të udhëheqjes. Dhe e gjithë kjo luftë bërrylash që vazhdoi deri në kongres dhe të cilën duhet thënë se televizioni me mjeshtëri e pasqyroi “ mirë ”, la një shije të hidhur, shumë të hidhur tek elektorati i Partisë socialiste, shije që përgatiti atë indiferencë të këtij elektorati në zgjedhjet e 20 Tetorit. A mund të spjegohet kjo vetëm me karrierizmin e një pjese të udhëheqjes? Vështirë për ta besuar. Fakti që idealisti i madh dhe tribuni popullor Dritëro Agolli, luajti rolin kryesor për të shmangur me të madhen që do të ishte përçarja, pra luajti rolin e një politikani të urtë dhe largpamës, për të cilën kongresi atij i dha më shumë vota se të gjithë të tjerëve, pra ky fakt, flet se nuk ishte vetëm karrierizmi, ai që e krijoi këtë shije të hidhur. Për opinionin publik kjo ngjarje përbën një enigmë të madhe të luftës politike, njësoj si ngjarja e 28 Majit për partinë demokratike. Megjithatë është çështje e brëndëshme e Partisë socialiste ta sqarojë apo jo, ashtu siç është përsëri çështje e brëndëshme e Partisë Demokratike ta sqarojë apo jo enigmën e 28 Majit.

Po më tej. Perspektiva e luftës politike

Analiza e mësipërme ishte shumë e lehtë. Pasi ajo bëhej mbi bazën e atyre që kanë ndodhur të cilat njerëzit i kanë përjetuar. Natyrshëm shtrohet pyetja: Po më tej. Cila do të jetë perspektiva e luftës politike, cili do të jetë qëndrimi i pushtetit? Vështirë për tu parashikuar me saktësi. Në pamundësi të kësaj kemi të drejtë të bëjmë disa supozime që mund të vertetohen ose jo.

Partia demokratike tani që përfundimisht e siguroi pushtetin dhe për katër vjet, mund ta ulë tensionin politik në drejtim të opozitës dhe të jetës politike e sociale në terësi. Kjo mund të shoqërohet me krijimin e një klime sociale më të qetë, me lirimin e të burgosurve politikë, veçanërisht të Fatos Nanos. Kjo mënyrë sjelljeje që natyrisht nuk mund t'i pëlqejë segmenteve revanshiste që ekzistojnë në gjirin e saj, do t'ia rrisë kredibilitetin Partisë Demokratike në shtresat e popullsisë shqiptare. Por njëkohësisht do bëjë të pavlefshme dhe propagandën e opozitës në sytë e elektoratit të saj si dhe do përmirësojë imazhin e saj në gjirin e bashkësisë ndërkombëtare. Natyrisht ky është një variant. Por ka dhe një variant tjetër. Mbi bazën e rezultateve të zgjedhjeve të 20 tetorit, të cilat i pranoi dhe opozita, në gjirin e pushtetit mund të thellohet instikti i hakmarrjes

dhe revanshit. Fakte dhe materiale për ta justifikuar ka boll. Të sharat dhe akuzat e opozitës ndaj pushtetit pas 26 Majit janë të shumta dhe të panumurta. Njerzit janë akoma të nxehtë për më tepër kur kanë pushtetin në dorë. Instikti i hakmarrjes mund të shfaqet në një formë arsyetimi të tillë: “ Hë, ku jini tani ju opozitarët që mbushët botën me akuza ndaj nesh. Ja pra bëmë dhe zgjedhje të lira, rezultatin e të cilave dhe ju e pranuat vetë, e pranoi dhe bota. Të gjitha i fituam dhe tani ju kemi në dorë. Duhet t’i hidhni poshtë akuzat që na keni bërë, ndryshe e keni keq ”. Kjo mënyrë të menduari dhe vepruari po t’i lihet terren i lirë, do ta tensionojë akoma më shumë klimën politike dhe sociale në Shqipëri. Partisë në pushtet veç nxjerrjes së dufit të çastit dhe pasioneve primitive do t’i sjellë vetëm dëm të madh, duke favorizuar akoma më shumë opozitën si dhe duke e rreshtuar opinionin ndërkombëtar akoma më shumë në anën e saj. Por dhe ky është vetëm një supozim.

Logjika politike e ftohtë të thotë se pushteti në Shqipëri, do ndjekë variantin e parë, duke e spostuar krahun revanshist nga pushteti dhe ushtrimi i pushtetit. Në gjirin e pushtetit aktual, megjithse në hije, ka njerëz që mendojnë më shumë për përfitimet e perspektivës se sa të politikës së ditës.

A do ketë qeverisje të përbashkët midis demokratëve dhe socialistëve Çështë kjo pyetje paradoksale do thonë menjëherë fanatikët e të dy partive. Kurrë, do thonë politikanët dhe propagandistët e zjarrtë. Por le t’i lëmë ata të bëjnë punën e tyre dhe tja nënshtrojmë pyetjen e bërë analizës së ftohtë politike. Nuk bëhet fjalë për sot, as pas pesë muajsh apo një viti. Bëhet fjalë për më vonë, për vitet e fundit të shekullit. Pyetja ka në bazë perspektivën e zhvillimit politik dhe ekonomik të Shqipërisë.

Le të marrim të parin; perspektivën e zhvillimit ekonomik të vëndit. Aktualisht, në fushën ekonomike lufta në Shqipëri zhvillohet midis tre grupimeve kapitaliste. Grupimit kapitalist që mbështetet nga partia demokratike, grupimit kapitalist që mbështetet nga partia socialiste dhe grupimit tradicional kapitalist që mbështetet nga partia republikane, disa parti të tjera të djathta dhe shoqata e ish të shpronësuarve. Dy grupimet e para e kanë zanafillën qysh në kohën e partisë së punës, njerëzit që i përbëjnë këto grupime janë njerëz ish komunistë apo ish simpatizantë të komunizmit. Ndërsa grupimi i tretë janë përfaqësuesit e ish klasave të shpronësuarra dhe të përmbysura nga partia e punës pas viteve 1945-1946. Veçori e këtij grupimi, pra e grupimit të tretë, është se të njëjtat aspirata me të ka dhe një shtresë ish komunistësh. Në efektivin prej 180 mijë vetësh të partisë së punës, rreth 18900 komunistë rrihnin nga familje të pasura të Shqipërisë, por që pasuritë e tyre i kishin falur pas 1946-ës. Grupimi i tretë ka me vehte të drejtën historike, por nuk ka pushtetin politik, është i përçarë në disa parti politike, nuk ka politikanë të zotë sot për sot, prandaj ai dhe manipulohet përgjithësisht lehtë si nga Partia Demokratike, ashtu dhe nga Partia socialiste. Në këto kushte grupimi kapitalist që mbështetet nga partia demokratike e ka të lehtë ta përballojë atë, prandaj nuk e ndjen nevojën e aleancës me grupimin kapitalist që mbështetet nga partia socialiste. Por kjo është vetëm për sot. Nuk kemi të drejtë të themi se dhe nesër do të jetë kështu. Fare mirë mund të ndodhë dhe do të ndodhë, që nesër grupimi kapitalist që ka të drejtën historike me vehte të konsolidohet në një parti të vetme, të nxjerrë nga gjiri i tij politikanë të zotë. Greva e urisë i shoqatës së të shpronësuarve ishte sinjali i parë. “ Rebelimi ” i Kurt Kolës dhe deklaratat e tij janë shënja e dytë. Deklaratat e Abaz Ermenjit pas 26 Majit janë shënja e tretë. Të tjera do të ketë në të ardhmen. Kjo do të krijojë një situatë të re për pushtetin. Për ta përballuar rrezikun që i kanoset grupimi kapitalist që sot ka pushtetin do

kërkojnë aleatë. Dhe aleati më i mundshëm është grupimi kapitalist që mbështetet nga partia socialiste. Në këtë rast interesat e tyre ekonomike do të puqen, pasi të dy janë pjella të Shqipërisë komuniste. Dhe kur puqen interesat ekonomike, ato politike është shumë lehtë të puqen.

Momenti i dytë është politik. Nëqoftëse vezhgohet me kujdes situata sociale në Shqipëri nuk mund të mos vësh re se në gjirin e shtresave të ndryshme të shoqërisë shqiptare, ka filluar të lindë një shtresë nacionaliste veçanërisht tek moshat e reja që kanë disa vite që kanë parë botën me sy. Kjo shtresë bashkë me përbuzjen që ka ndeshur ka fituar dhe një sasi të hollash të cilat po i investon në Shqipëri në forma të ndryshme. Tipari i kësaj shtrese është se ajo nuk e harron përbuzjen që ja kanë shkaktuar të huajt. Ajo nuk harron se e vetmja “vizë” që i dhanë të huajt ishin motoskafët dhe varkat plastike për në Itali. Por interesi për të fituar disa para e ka bërë që ta gëlltisë fyerjen dhe përbuzjen, por jo ta harrojë atë. Tipar tjetër i saj është se kjo shtresë jo vetëm që sot është qindra mijëshe, por ajo vazhdon të rritet me shpejtësi. Tipar tjetër i saj është se ajo tek asnjë nga partitë e mëdha politike të Shqipërisë, nuk gjen përgjigje për aspiratat dhe dëshirat e saj. Ajo është e ftohtë dhe indiferente si ndaj së majtës, ashtu dhe ndaj së djathtës. Se çfarë ngjyrimi politik do të ketë kjo shtresë, do të jetë nacional komuniste, do të jetë nacional socialiste, apo do të jetë anarkiste, kjo nuk dihet. A do të dalë më vehte si parti apo grupacion kjo shtresë qindra mijëshe, apo Baleta dhe Kalakula do ta përfshijnë në partitë e tyre dhe kjo nuk dihet. Por një gjë dihet me siguri. Mbas dy-tre vjetësh një shtresë e tillë do ketë dalë plotësisht në skenën politike shqiptare. Në këto kushte politike, si partia socialiste ashtu dhe partia demokratike do të kenë vetëm një alternativë: Të vazhdojnë luftën me njëra tjetrën duke qënë njësoj të rrezikuara apo të kërkojnë aleancën me njëra tjetrën. Që të dyja ato janë parti me fizionomi politike kozmopolite. Nevoja për të përballuar shtresën nacionaliste në formën e nacional komunizmit, të nacional socializmit apo të anarkizmit, do t'i bëjë të harrojnë ashpërsinë dhe tensionet e luftës politike së sotme politike dhe të qeverisin së bashku.

Pse propaganda në Kosovë ju kundërvu kryengritjes së marsit 1997  
(Prill 1997)

Revolta popullore që shpërtheu në Shqipëri në fillim të muajit Mars 1997, ka vënë në lëvizje të gjithë jetën politike dhe propagandistike shqiptare që nga Prishtina deri në Sarandë. Janë me qindra dhe mijra komente, informacione, analiza, gjykime për këto ngjarje. Rrallë herë jeta politike dhe propagandistike shqiptare është shfaqur kaq hapur, kaq lakuriq sa këtë herë.

Por dhe rrallë herë janë shfaqur disa dukuri trishtuese të jetës politike shqiptare se sa këtë herë. Këto dukuri janë të shumta, por do të evidentojmë disa prej tyre.

Krahinarizmi primitiv në pluralizëm

Krahinarizmi përbën një ndër tiparet kryesore të politikës dhe propagandës shqiptare të kësaj periudhe. Shumica e politikës dhe propagandës së Kosovës e ka shfaqur këtë tipar me hapur se kurrë. Një analizë e shkrimeve dhe deklaratave të mjaft politikanëve dhe gazetarëve nga Kosova, gjatë kësaj periudhe janë rreshtuar përkrah Berishës dhe grupit të tij. Cila është arsyeja? Po të lexosh shkrimet dhe deklaratat e tyre, nuk gjen asnjë arsye politike, ideologjike apo nacionale. E vetmja arsye për ata është fakti se Berisha është nga veriu, ata që u revoltuan ndaj tij janë nga jugu. Prandaj Berisha duhet mbrojtur, duhet

përkrahur, se ai është nga krahina jonë, të tjerët janë nga krahina të tjera prandaj janë armiq. Këtë vijë sjelljeje e gjen tek deklaratat, shkrimet, analizat e shumë politikanëve, gazetarëve dhe analistëve politike në Kosovë

Shkrimet e kësaj periudhe treguan veçanërisht në Kosovë se ndjenja e krahinizmit është shumë më e fuqishme se bindjet politike. Fakt i qartë për pohimin e mësipërm është kundërvënia e politikës dhe propagandës së Kosovës dhe ndaj vijës politike të Ibrahim Rugovës. Është tashmë e njohur se Rugova ndaj ngjarjeve në Shqipëri bëri një veprim të mënçur politik. Ai jo vetëm që u distanca nga Berisha duke kërkuar krijimin e një qeverie koalicioni dhe zgjedhje të parakohshme, por shkoi dhe më tej duke e ftuar Berishën të jepte dorëheqje. Me këtë veprim Rugova doli hapur si zëdhënës i qëndrimeve të Amerikës. Megjithkëtë, mjaft analistë, publicistë dhe politikanë antarë të partisë së Rugovës apo aleatë të tij, dolën hapur në mbrojtje të Berishës dhe ju kundërvunë Kryetarit të tyre. Nuk ishin bindjet politike që sollën këtë qëndrim, nuk ishte merakuri i Kosovës, por ishte thjesht « kushtrimi i të parëve », ishte ndjenja e krahinizmit primitiv ajo që doli lakuriq në qëndrimin e tyre. Mentaliteti i fisit, i bajrakut, i qehajait apo kajmekamit është i tillë ; ai nuk e kapërcen dot kufirin e fisit apo të bajrakut. Megjithse jeton në fundin e shekullit të 20-të, megjithse hiqen modernë demokratë e bashkëkohorë, njerëz të tillë në thelbin e tyre, jetojnë me mëndësitë e shekullit të 19-të. Të gjithë ata që ngrihen kundër të parit të fisit apo të bajrakut të tyre, për ata janë armiq, tradhëtarë, që duhen ndëshkuar dhe dënuar.

Tezat greke si mjet propagande

Në shumicën e propagandës në Kosovë ndaj ngjarjeve në Shqipëri dhe veçanërisht ndaj Kryengritjes, vihet re një element shumë i « çuditshëm ». Kjo propagandë i ka sulmuar dhe vazhdojë t'i sulmojë me tërbim këtë ngjarje me lloj lloj emërtimeve nga më të neveritshmet. Por ajo që bie më shumë në sy është fakti se me dashje apo pa dashje kjo në thelbin e saj nuk është gjë tjetër veçse jehonë e tezave greke. Cili është thelbi i kësaj propagande ? Ja disa pohime : « Jugun e kanë marrë grekët. Ata që janë ngritur kundër Berishës janë grekë, në Vlorë luftojnë grekët, në Tepelenë përsëri janë grekët. Të gjithë ata që janë nga jugu si Fatos Nano, Fatos Lubonja, etj janë grekë » etj, pohime si këto. Le të prekim shkarazi dhe tezat shoviniste greke. Sipas këtyre tezave në Shqipëri jetojnë me shumë se 400 mijë grekë. Pra gati të gjithë shqiptarët të besimit ortodoks sipas shovinizmit grek, janë grekë. Kjo tezë qindravjeçare greke, që barazon besimin fetar me kombësinë, asnjëherë nuk ka zënë vënd në Shqipëri, veçanërisht tek shqiptarët e besimit ortodoks. Rilindasit dhe patriotët e mëdhenj si Naun Veqilharxhi, Thimi Mitko, Jani Vreto, Petro Luarasi, Parashqevi Qiriazi, Thanas Tashko, Koto Hoxhi, Papa Kristo Negovani, Spiro Bellkameni, Mihal Grameno, Themistokli Gërmenji, etj shqiptarë të besimit ortodoks, historia e Shqipërisë i njih nga figurat më të shquara atdhetare të saj që i bënë ballë shovinizmit grek duke dhenë dhe jetën e tyre për rilindjen e Shqipërisë. Por pati dhe disa si Kristaq dhe Jorgji Zografos apo Spiro Milo, që u bënë mbështetësit dhe përhapësit e tezave shoviniste greke se e gjithë Shqipëria e jugut është greke, se të gjithë shqiptarët e besimit ortodoks janë grekë etj. Historia shqiptare këta i ka stigmatizuar si tradhëtarë dhe shërbëtorë të shovinizmit grek. Sot pas 80 vjetësh përsëri tezat shoviniste greke i mbrojnë qarqe ultra nacionaliste greke. Por me e çuditshmja dhe më e habitshmja është se sot këto qarqe shoviniste kanë gjetur përkrahës të tyre në Shqipëri, kanë gjetur « Kristaq dhe Jorgji Zografos ». E veçanta është se këta përkrahës dhe mbështetës të tezave greke, sot janë nga Prishtina. E veçanta tjetër është se ata sot nuk quhen « Kristaq apo



Jorgji », por quhen Teki, Gani, Abdi, Xhaferr, Rrahman, Adem, Bajram, Mehmet etj

Vëllezrit serbë dhe armiqtë shqiptarë

Në qëndrimin e një pjesë të politikës dhe propagandës nga Kosova për ngjarjet në Shqipëri, vihet re dhe një dukuri tjetër. Në propagandën e tyre, të gjithë e pranojnë se Kosova është e pushtuar nga Serbia. Të gjithë ata në teori e pranojnë se platforma serbe ndaj Kosovës është e njëjtë si për nacional-komunistët e tipit të Milosheviçit ashtu dhe për nacional socialistët e tipit të Drashkoviçit. Ashtu siç pranojnë në teori se pa ndihmën e popullit shqiptar në Shqipëri, nuk e zgjidhin dot çështjen e tyre, se shqiptarët e Shqipërisë janë vëllezër etj. Por le të shikojmë praktikën. Ajo flet ndryshe, bile kthehet kokë poshtë. Në praktikë armiqtë serbë bëhen « vëllezër », ndërsa vëllezërit shqiptarë bëhen « armiq ». Ja disa fakte : Egërsia e shkrimeve ndaj ngjarjeve në Shqipëri dhe veçanërisht ndaj kryengritjes, ua kalon disa fish shkrimeve që botohen ndaj dhunës serbe. Në kohën e demonstratave në Beograd të drejtuara nga çetniku Drashkoviç, politika dhe propaganda në Kosovë demonstruesit i bëri heronj, bile u dërgoi dhe telegrame urimi. Megjithatë të gjithë e dinin se Drashkoviçi ndryshon nga Milosheviçi vetëm nga kostumi dhe asgjë tjetër. Ndërsa për revoltën në Shqipëri, po të njëjtët njerëz, ndaj protestuesve shqiptarë dërguan vetëm mallkime, vetëm sharje, vetëm kërcënime, nxorrën nga arsenalit tyre sharjet më të neveritshme. Njëri prej tyre dhe ndër më të njohurit, në një nga intervistat e tij, serbët i quajti « vëllezër », ndërsa shqiptarët që bënë kryengritje, i quajti armiq dhe kërkoi që mbi ta të ushtrohej dhuna e egër e shtetit.

Përse gjithë kjo urrejtje ?

Me të drejtë lind pyetja : Përse gjithë kjo egërsi ndaj revoltës në Shqipëri ? Thjesht për krahinarizëm ? Siç duket ekziston një shkak më i thellë. Revolta në Shqipëri që nxorri në shesh gjithë kalbësirën dhe shëmtinë e pushtetit shqiptar, që nxorri në shesh gjithë mashtrimin kolosal pesëvjeçar të fshehur pas fjalës demokraci, i tmerroi politikën dhe propagandën në Kosovë. Mashtrim dhe shëmti në periudhën 1991-1997, nuk kishte patur vetëm në Shqipëri, por dhe në Kosovë. Politikës dhe propagandës në Kosovë, duke parë revoltat dhe kryengritjen e popullit shqiptar, pyetja e parë që i erdhi në mend, ishte : « Po sikur dhe tek ne në Kosovë, populli të ngrihet siç u ngrit në Shqipëri, ku do të shkojmë ne, ku do të shkojnë mashtrimet tona, shëmtia jone. Dhe ne do të pësojmë fatin e pushtetit në Shqipëri bile më keq, se ne jemi dhe kolaboracioniste me serbët. Prandaj me çdo kusht të parandalojmë këtë gjë » Analiza e e botuar në gazetën gjermane « Die Welte » e përkthyer dhe e botuar nga Jusuf Buxhovi në Rilindje me titull : « Vlora nuk teston vetëm Shqipërinë por tërë Ballkanin », ishte një këmbanë e fuqishme alarmi për këtë shtresë. Prandaj një pjesë e tyre u shkëput nga pushteti shqiptar duke mbajtur qëndrim kritik ndaj tij, ndërsa më fanatikët u hodhën në sulm për ta paraqitur revoltën popullore si antishqiptare. Me këtë spjegohet dhe ai sulm i egër kundër Rexhep Qosjes, që ngjarjet në Shqipëri i konsideroi me të drejtë si Revolucion demokratik. Këtë shtresë e tmerron fjala revolucion, fjala kryengritje, e lë pa gjumë, prandaj dhe ajo është e pamëshirshme ndaj revolucionit dhe kryengritjes. Në pamundësi ta shuajë atë qysh në lindje, ajo bën çmos që të mos përhapet, bën çmos që atë ta diskreditojë, ta paraqesë në sytë e opinionit ashtu siç nuk është.

Interpretimet e të huajve

a-Interpretimet e shtypit dhe mediave televizive

Në shumicën dërrmuese shtypi dhe mediat kryesore të huaja i mbështetën në fazën e parë revoltat dhe rebelimin e popullit të armatosur. Në këtë fazë, në kundërshtim me propagandën zyrtare të Shqipërisë, asnjëherë propaganda euroamerikane, kryengritësit nuk i quajti banditë apo kriminelë. Termi më i përhapur në shkrimet dhe komentet e tyre ishte termi “ kryengritje popullore dhe popull i armatosur ”. Një tipar tjetër i kësaj propagande është se gjatë periudhës Janar-Prill 1997, u shpeshuan akuzat e shtypit dhe mediave televizive ndaj pushtetit shqiptar duke e konsideruar atë si pushtet diktatorial. Në mjaft stacione televizive të huaja si në Gjermani, Itali, Zvicër, Angli etj, filloi të flitej hapur se demokracia në Shqipëri ishte një farsë dhe se atje sundonte pushteti i një njeriu të vetëm me prirje të theksuara diktatoriale. Në interpretimin e ngjarjeve në Shqipëri nuk kanë munguar dhe mjaft shkrime kritike ndaj qeverive evropiane perëndimore për indiferencën dhe përkrahjen që i kishin dhënë një pushteti diktatorial.

Në disa shkrime, këto ngjarje u interpretuan nga pozita shoviniste dhe raciste ndaj kombit dhe popullit shqiptar. Thelbi i këtyre interpretimeve ka qënë gjoja pamundësia e shqiptarëve për të mbajtur shtetin dhe për tu vetëqeverisur. Kritikkat ndaj qeverisjes së keqe, u përgjithësuan dhe trajtuan si kritika ndaj aftësisë së popullit shqiptar për të bërë dhe mbajtur shtet. Në mënyrë cinike, ky lloj shtypi la në harresë periudhën 1920-1939 dhe 1945-1992, kur pavarsisht nga forma qeverisëse e regjimit, shteti shqiptar ishte konsoliduar si i tillë. Në ndihmë të këtyre interpretimeve ishin dhe thirrjet neveritëse të klasës politike shqiptare për nevojën e një force shumëkombëshe.

b-Interpretimi i kancelarive euroamerikane

Në interpretimin e ngjarjeve në Shqipëri, në ndryshim nga mediat e ndryshme, interpretimi i kancelarive euroamerikane, përshkohet nga dy veçori:

Veçoria e parë ka të bëjë me vonesën e reagimit zyrtar të kancelarive euroamerikane ndaj këtyre ngjarjeve.

Veçoria e dytë ka të bëjë me diferencën e qëndrimit amerikan nga qëndrimi i Unionit evropian ndaj këtyre ngjarjeve veçanërisht në fazën e parë të zhvillimit të tyre. Qëndrimi amerikan, konstant pas zgjedhjeve të 26 Majit, qysh në fillim të ngjarjeve fajësoi ashpër qeverinë shqiptare si shkaktaren kryesore të trazirave në shqipëri. Për daljen nga kriza qeveria amerikane përsëriti qëndrimin e saj për krijimin e një qeverie koalicioni dhe zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme. Sekretarja amerikane e shtetit Madlenë Olbrajt e shprehu hapur këtë qëndrim gjatë vizitës në Evropë duke kërkuar nga evropianët që të kenë një qëndrim të njëjtë ndaj qeverisë shqiptare. Por siç tregoi zhvillimi i ngjarjeve, Këshilli i Ministrave të Bashkimit evropian nuk e pranoi në fillim rekomandimin amerikan duke e zbutur qëndrimin ndaj qeverisë shqiptare me anë të një deklarate të përgjithshme ku kërkohet thellimi i reformave ekonomike. Kjo diskordance në qëndrimin ndaj ngjarjeve në Shqipëri ashtu si do ta shikojmë me poshte, nuk është gjë tjetër veçse refleks i kontradiktave midis fuqive të medha dhe luftes së tyre për zonë influencë. Ndërsa në fazën e dytë të zhvillimit të ngjarjeve në Shqipëri qëndrimi euroamerikan u njehsua dhe kjo nuk ndodhi rastësisht. Ishin ngjarjet që precipituan me shpejtësi në Shqipëri, ato që i detyruan kancelaritë evropiane të ndryshonin qëndrimin e tyre. Në këtë fazë ato u rreshtuan në anën e popullit kryengritës duke i pranuar kërkesat e tij.

Pavarsisht nga manovrimet e fundit, duhet thënë se qëndrimi euroamerikan dhe politika e

tyre ndaj Shqipërisë dhe qeverisë se saj u diskreditua plotësisht nga lëvizja popullore në Shqipëri dhe nga shtypi dhe televizioni i pavarur perëndimor. Konkluzioni i revoltave të popullit shqiptar ishte se kanceleritë euroamerikane kishin mbrojtur dhe përkrahur në Shqipëri një qeveri gangsterësh dhe hajdutësh dhe jo një qeveri demokratike.

Thelbi i revoltave popullore

Revolta popullore që shpërtheu në Shqipëri, prapa interpretimeve dhe kualifikimeve të pushtetit shqiptar, të opozitës shqiptare dhe të propagandës euroamerikane, prapa parullave që u hodhën dhe manipulimeve që u bënë nga forca të ndryshme politike për elektorat, e zhveshur nga preteksti për të cilin shpërtheu, ka thelbin e saj real. Përkrahja që ju dha asaj nga zona të ndryshme të vëndit, pjesmarrja në Vlorë e përfaqësuesve të Shkodrës, Lezhës, Mirditës apo Matit, i jep asaj domethënie shumë më të gjërë dhe më të thellë se dhe përmbajtja më e gjerë e dhënë nga politika dhe propaganda pozitive shqiptare apo e huaj.

Lëvizje për dinjitet kombëtar

Analiza dhe studimi i morisë së shkrimeve, deklaratave dhe intervistave, të dhjetra dhe qindra interpretimeve të dhëna nga shqiptarë dhe të huaj, analiza e thelbit të lëvizjes popullore jashtë skemave dhe preferencave partiake apo luftës për pushtet dhe për zona influence, në mënyrë të natyrshme të nxjerr në një konkluzion të rëndësishëm në formë pyetjeje: Cili është thelbi i këtyre revoltave apo i këtij “ revolucionit të vonuar demokratik ” siç e quan Rexhep Qosja, apo i kësaj “ kryengritje popullore ” siç e quan Dritëro Agolli. Revoltat popullore në Shqipëri, rastësisht filluan në Jug, rastësisht nisën me shëmbjen e fondacioneve piramidale. Por domosdoshmërisht ato u përhapën në të tërë Shqipërinë, domosdoshmërisht ato do të fillonin një ditë. Shëmbja e fondacioneve piramidale nuk ishte shkaku i saj, në të kundërtën ishte preteksti i saj. Ngjarjet në Shqipëri nuk patën në thelbin e tyre luftën për pushtet, nuk patën në thelbin e tyre kthimin e parave të humbura, nuk patën në thelbin e tyre programin e asnjë partie politike shqiptare të majtë apo të djathtë. Përse? Sepse në thelbin e tyre ato ishin një Lëvizje e fuqishme për dinjitet kombëtar, në thelbin e tyre ato ishin patriotike kombëtare. Thelbi i tyre nuk është gjë tjetër veçse lufta e atdhetarizmit shqiptar që po rilind me kozmopolitizmin e partive politike shqiptare. Per ta kuptuar me mire pohimin e mesiperm, është e domosdoshme përmbledhja e asaj që u quajt demokraci në Shqipëri në vitet 1992-1997. Elementet e kësaj demokracie, të cilat populli shqiptar i vuajti në kurrizin e tij janë :

Demokracia e poshtëritimit. Asnjëherë populli shqiptar gjatë gjithë historisë së tij nuk ka qënë më i poshtëruar nga propaganda e të huajve, se sa gjatë periudhës 1992-1997. Me dhjetra filma, libra, reportazhe, komente fyese e denigruese janë përhapur në Europë, ndërsa klasa politike shqiptare, këtë qëndrim shovinist dhe racist e paraqiste si shprehje të lirisë së individit.

Demokracia e përdhunimit të historisë. Asnjëherë popullit shqiptar nuk i është përdhunuar historia kombëtare më shumë se sa në periudhën 1992-1997, kur nga politika zyrtare shqiptare, periudha historike 1945-1991, u quajt dhe u konsiderua as më shumë dhe as më pak si një histori e humbur. Gjatë kësaj periudhe populli shqiptar u bë objekt përbuzjeje dhe racizmi i mjaft krijimeve kulturore dhe artistike të të huajve. Filma të tillë si “ Lamerika ”, “ Ata vinin nga malet me borë ”, romane si “ Kameleoni ”, dhjetra emisione televizive që fillonin dhe mbaronin me nga një xhami, nuk ishin gjë tjetër veçse një shovinizëm i kulluar “ demokratik ”, i bekuar nga politika zyrtare e shtetit shqiptar.

Nën maskën e luftës kundër komunizmit, klasa politike shqiptare në fakt i bëri gjyqin dhe përdhunoi racën shqiptare.

Demokracia e shkatërrimit të shtetit. Klasa politike shqiptare, që pretendonte se do ta shkatërronte komunizmin në Shqipëri, në fakt realizoi një gjë tjetër shumë makabre. Ajo arriti të shkatërronte vetë shtetin shqiptar. Në ngjarjet e pranverës 1997, gjatë kryengritjes popullore, praktikisht shteti shqiptar pushoi se ekzistuari dhe Shqipëria u rikthye realisht në vitin 1913, kur për të mbajtur gjallë shtetin një vjeçar shqiptar, në Shqipëri u vendosën forcat shumë kombëshe.

Demokracia e pabesisë. Klasa e sotme politike shqiptare është e vetmja klasë politike në gjithë historinë e shtetit shqiptar, që në themel të veprimtarisë se saj nuk vuri asnjë ligj juridik apo kod moral, por vetëm pabesinë.

Demokracia e parave të pista. Në marrdhëniet me popullin që i përkiste, klasa politike shqiptare e periudhës 1992-1997, bëri një krim të pashëmbullit. Në vënd të ndërtonte ekonominë reale të tregut dhe kapitalizmin e punës së ndershme, ajo punoi me të gjitha forcat për të ndërtuar “ njeriun e zi ”, që jeton si parazit, pa punuar vetëm me përqindjet e fajdeve të fondacioneve të piramidale. Duke i hequr popullit shqiptar të drejtën për të punuar, kjo klasë politike, realisht projektoi vdekjen e popullit që i përkiste.

Demokracia e hajdutëve dhe mashtruesve. Është e vetmja periudhe në historinë e popullit shqiptar, ku hajdutët dhe mashtruesit nuk jetojnë vetëm në gjirin e shoqërisë si çdo shtresë shoqërore, por arrijnë të bëhen sunduesit e shoqërisë.

Demokracinë e mësipërme e provoi në kurriz gjithë populli shqiptar, pavarësisht nga bindjet politike dhe përkatësitë partiake. Kjo ishte pikënisja e asaj lëvizjeje të fuqishme popullore që do t'i bashkonte të gjithë shqiptarët në një front të përbashkët. Konkluzioni i mësipërm rrjedh në mënyre logjike nga analiza e disa dukurive të pavëna në dukje nga politologjia dhe publicistika shqiptare dhe e huaj deri më sot. Evidentimi i tyre, e bën të plotë dhe të argumentuar konkluzionin sipas të cilit ngjarjet në Shqipëri janë një Lëvizje e fuqishme kombëtare.

Së pari: Në lëvizjen popullore që shpërtheu në Shqipëri, morën pjesë shtresa popullsie me pikpamje politike të ndryshme. Për herë të parë në periudhën e pluralizmit u gjëndën të bashkuar në një front të vetëm, njerëz me pikpamje socialiste, demokratike, monarkiste, social-demokrate, republikaniste etj. Të gjithë ata u ngritën realisht mbi programet e partive politike që u përkisnin apo që pëlqenin. Kjo dukuri u pasqyrua më vonë edhe në organizmat udhëheqëse të lëvizjes popullore që u quajtën Komitetet e Shpëtimit Publik. Mjafton të përmëndim vetëm një fakt; kryetari i Komitetit të Shpëtimit Publik të qytetit të Beratit, u caktua një nga themeluesit e Partisë Demokratike shqiptare në këtë qytet. Është një fakt i pranuar nga të gjithë që njohin historinë e lëvizjeve popullore se bashkimi në një lëvizje i shtresave me pikpamje politike dhe ideologjike të ndryshme, është elementi i parë dhe qënësor i një Lëvizjeje thellësisht kombëtare.

Së dyti: Armatosja e gjithë popullit që u ngrit në revoltë, është një element tjetër që flet për një lëvizje atdhetare me karakter thellësisht kombëtar. Partitë politike në Shqipëri të ish-opozitës duke filluar që nga Partia Socialiste dhe duke mbaruar tek partia e Aleancës Demokratike, janë të gjitha parti që kanë në programet e tyre dialogun dhe rrugën paqësore. Ato janë të paafta të rrëmbejnë armët, të cilave u frikësohen shumë. Vetëm një Lëvizje kombëtare jashtë kornizave të kozmopolitizmit të partive politike shqiptare është në gjëndje të armatoset dhe t'i mbrojë kërkesat e saj me armë.

Së treti: Kalimi masiv i ushtrisë dhe i policisë në anën e popullit të revoltuar përbën

elementin e tretë që i jep Lëvizjes që shpërtheu në Shqipëri, një karakter thellësisht kombëtar. Asnjëherë ushtria dhe policia nuk kalon masivisht në anën e kësaj apo asaj partie politike në një vënd ku ka me dhjetra parti politike. Kur ushtria dhe policia kalon masivisht në anën e një lëvizjeje, kjo do të thotë se kjo lëvizje ka karakter thellësisht kombëtar dhe patriotik. Shumë analistë shqiptarë dhe të huaj e kanë shpjeguar kalimin masiv të ushtrisë në anën e kryengritjes me faktin se midis pjestarëve të ushtrisë kishte njerëz që kishin humbur paratë. Disa të tjerë e kanë shpjeguar me faktin se ushtria dhe policia shqiptare ishin të papërgatitura. Janë të gjitha interpretime ose naive ose qëllimkeqe, që me dashje apo padashje duan të mbulojnë shkakun e vërtetë të ndodhisë. Ushtria dhe policia, kaluan në anën e popullit jo sepse kishin humbur paratë, jo sepse ishin të papërgatitur, por sepse e ndienë se kishin të bënin me një lëvizje që nuk luftonte për pushtet, poste dhe privilegje, por vetëm për dinjitet kombëtar. Para ushtrisë shqiptare u shtrua dilema : Të mbronte ata që e kishin urdheruar por që ishin të korruptuar, që patriotizmi i tyre fillonte e mbaronte tek kolltuku qeveritar, apo të kalonte në anën e tyre që ishin të revoltuar, të varfëruar, por që patriotizmi i tyre fillonte tek pragu i shtëpisë dhe mbaronte në cepin më të largët të trojeve shqiptare? Dhe ushtria shqiptare në përgjithësi e zgjidhi dilemën shumë mire. Ajo kaloi në anën e popullit. Me këtë akt, ushtria dhe policia shqiptare treguan një akt të madh patriotizmi, treguan se dhe ato kërkojnë dinjitet kombëtar. Është kjo arsyeja që ish-pushteti shqiptar, kur pa se shumica e ushtrisë nuk ju bind urdherave të tij, u hakmorr ndaj saj në mënyrë të egër dhe barbare. Me anën e militantëve të tij, ai e ndëshkoi mos bindjen e ushtrisë, duke shkatërruar në mënyrë makabre bazën materiale dhe logjistike të saj. Analizat që janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen në Shqipëri për këtë çështje madhore, dëshmojnë se shkatërrimet e ushtrisë ndodhën masivisht pasi në Shqipëri ishte krijuar “ »Qeveria e Pajtimit Kombëtar« ”, dhe veçanërisht në disa zona të cilat nuk ishin prekur masivisht nga revolta popullore si në disa rajone të veriut dhe disa rajone të Shqipërisë së mesme.

Se katërti: Sistemi i mëparshëm në Shqipëri ishte një sistem nacional -komunist. Partitë politike shqiptare të pluralizmit veçanërisht pushteti shqiptar, nga trashëgimia e së kaluarës, hodhi poshtë nacionalizmin dhe mbajti gjalle vetëm praktikën me të keqia të organizimit shtetëror, si eliminimin e kundërshtarëve politikë, teorinë e biografive, persekutimin e atyre që flisnin ndryshe, ngritjen në sistem të korrupsionit duke e shndërruar Shqipërinë në një diktaturë kozmopolite të tipit latino-amerikan. Lëvizja kombëtare që ka shpërthyer në mbare Shqipërinë, synon të bëjë të kundërtën. Ajo nuk është komuniste, siç e etiketon propaganda e pushtetit shqiptar , as staliniste dhe mafioze siç ka filluar ta etiketojë dhe cilësojë një pjesë e propagandës perëndimore. Në të kundërtën, ajo është idealiste dhe romantike. Synimi i saj është që nga e kaluara të trashëgojë atë që u hodh poshtë gjatë periudhës 1992-1996, dinjitetin kombëtar dhe të hedhë poshtë të gjitha të këqijat e së kaluarës të manifestuara dhe të trupëzuara tek klasa politike shqiptare, veçanërisht tek pushteti shqiptar. Këtë e shprehu shumë qartë një nga drejtuesit e manifestuesve gjatë një interviste të dhënë seksionit shqip të BBC. Pyetjes se gazetarit se cili është qëllimi i revoltës popullore, ai ju përgjigj: “ Ne luftojmë që të fillojmë një epokë të re, në të cilën të rrojmë me dinjitet ”.

Së pesti: Karakteri idealist dhe patriotik i Lëvizjes popullore shqiptare, evidentohet qartë nëqoftëse mbajmë parasysh dhe një element të rëndësishëm të propagandës zyrtare shqiptare dhe asaj të huaj. Përbën një fakt tashmë të njohur se ish-pushteti shqiptar e njohu shpejt thelbin e revoltave popullore në Shqipëri. Prandaj ai u trëmb shumë dhe bëri

të gjitha përpjekjet për ta mbytur në gjak këtë lëvizje. Diktatura kozmopolite gjithmonë trëmbet nga Lëvizja kombëtare. Ngjyrë politike kanë partitë e ndryshme, populli nuk ka ngjyrë politike, ai ka vetëm një ngjyrë, përkatësinë kombëtare. Në pamundësi ta mbyste në gjak këtë lëvizje, propaganda zyrtare shqiptare ndërmoi fushatën e diskreditimit të saj. Emërtimet që ajo filloi të përdorë si “ stalinist, trockist, teori leniniste e marrjes së pushtetit, banditë, kriminelë etj ” të cilët sot janë me peshë emocionale negative, sinonim t’i hiqnin kësaj lëvizje mbështetjen gjithë popullore.

Evolucioni i propagandës euroamerikane

Ndërsa në propagandën euroamerikane, qëndrimi ndaj lëvizjes popullore shqiptare kaloi nëpër dy faza. Në fillim shumica dërrmuese e mediave perëndimore me anën e gazetarëve të dërguar në Shqipëri, i mbështetën revoltat popullore në mënyrë të plotë dhe të tërësishtme. Në analizat dhe komentet e tyre, ato flisnin me termin “ popull kryengritës apo popull i armatosur ”. Në një nga shkrimet analitike të botuar në fillim të muajit Mars 1997 ne gazetën e madhe gjermane “ Die Welt ” midis të tjerash theksohej se “ Vlora nuk teston vetëm Shqipërinë, por gjithë Ballkanin ”. Më vonë, pasi u njohën me thelbin kombëtar të Lëvizjes popullore, një pjesë e këtyre mediave, veçanërisht ato proqeveritare në shkrimet e tyre termin “ popull kryengritës apo popull i armatosur ” e zëvendësuan me termat “ rebelë, ish-komunistë, mafiozë, terroristë etj ”. Kushdo që i ka studjuar apo që i njihet sadopak lëvizjet kombëtare që ekzistojnë sot në botë, e di shumë mirë se ndaj tyre termat “ rebelë, mafiozë apo terroristë ”, janë ndër më të preferuarit e propagandës perëndimore.

Pjekuria e Lëvizjes Kombëtare

Lëvizja Kombëtare që shpërtheu në Shqipëri, me kulmin e saj, kryengritjen popullore, pati jetë shumë të shkurtër. Por sa kohë që ekzistoi, ajo tregoi një pjekuri të madhe politike dhe ideologjike. Ajo u ndesh me makinën propagandistike të ish-pushtetit shqiptar që synoi me të gjitha forcat ta kanalizonte në një lëvizje ideologjike.

Njëkohësisht, ajo u ndesh me propagandën e partive politike shqiptare të majta dhe të djathta, të cilat edhe hynë në një garë të pashpallur për të siguruar secila për llogari të saj sa më shumë elektorat. Por ajo u ndesh me propagandën dhe praktikën e kancelarive euroamerikane, të cilat bënë të pamundurën për ta fashitur dhe shuar këtë Lëvizje.

Përballë këtyre rreziqeve, Lëvizja shqiptare për dinjitet kombëtar, manovroi me zgjuarsiri dhe nuk ra në asnjë nga kurthet që ju ngritën. Në mënyrë të përmbledhur tre ishin rreziqet që u ndesh dhe përgjithësisht i përballoi me sukses.

1-Nacional-komunizmi

Në gjirin e pjesmarrësve dhe drejtuesve të revoltave popullore në Shqipëri, bënë pjesë dhe mjaft njerëz, të cilët kishin punuar në sistemin e mëparshëm në Shqipëri dhe që për shkak të bindjeve të tyre politike, u hoqën nga puna, veçanërisht nga drejtimi i ushtrisë shqiptare. Tek mjaft prej këtyre njerëzve ishte grumbulluar një zëmërim i egër kundër pushtetit dhe opozitës shqiptare në të cilin ishte përzier si poshtërimi kombëtar ashtu dhe poshtërimi personal. Brënda kësaj situatë, orientimi nacional-komunist ishte i mundshëm tek kjo shtresë. Por ata treguan një pjekuri të madhe politike. Ata vërtetë rrihnin nga sistemi i mëparshëm shqiptar, që nuk ishte gjë tjetër veçse nacional-komunizëm.

Megjithatë, nga togfjalëshi “ nacional-komunizëm ”, ata ruajtën dhe kultivuan në kushtet e pluralizmit, vetëm fjalën dhe përmbajtjen e fjalës “ nacionalizëm ”. Ky veprim i mënçur i kësaj shtrese, e bëri më të dukshëm karakterin kombëtar të revoltave popullore. Me qëndrimin që mbajti, kjo shtresë i dha një mësim të madh politikës dhe politikanëve

shqiptarë në dy drejtime : Së pari : Se çfarë duhet marrë dhe trashëguar nga e kaluara e afërt dhe e largët. Së dyti : Se në momentet kur vihet në rrezik ekzistenca si shtet, ideologjia kalon në plan të dytë dhe të tretë, ndërsa në plan të parë del patriotizmi.

## 2-Nacional-socializmi

Edhe nacional-socializmi, përbente një rrezik të mundshëm për lëvizjen kombëtare shqiptare. Në gjirin e kësaj lëvizjeje, mori pjesë aktivisht dhe një shtresë njerëzish që më përpara kishin qënë antarë apo simpatizantë të pushtetit të Partisë Demokratike dhe aleatëve të saj. Lidhja e tyre me pushtetin ishte mbështetur në shpresën që ju ishte dhënë se pushteti demokratik do tju siguronte një mirëqënie dhe prosperitet shumë më të madh se në te kaluarën. Prandaj ata i kishin shërbyer pushtetit të Partisë Demokratike, veçanërisht në fushatat elektorale, duke qënë një ndër faktorët kryesorë të fitores së P.D-se në zgjedhjet e zhvilluara në Shqipëri. Por me politikën që u ndoq në Shqipëri, veçanërisht me rrugët për zhvillimin ekonomik, që përfundoi me shëmbjen e fondacioneve të fajdeve, kjo shtresë u ndje e zhgënjyer dhe e mashtruar plotësisht. Prandaj në përbërjen e mjaft Komiteteve të shpëtimit publik, hynë dhe pjestare të kësaj shtrese. Duke mos patur në fillim një vijë të qartë, por vetëm ndjenjën e hakmarrjes ndaj atyre që i kishin mashtruar dhe prerë në besë, nacional-socializmi përbente një rrezik të mundshëm potencial në gjirin e lëvizjes kombëtare shqiptare. Por përsëri pjekuria e drejtuesve të saj, bëri që ky rrezik të shmangej plotësisht. Në zonat ku revoltat popullore ishin më të fuqishme, nga kjo shtresë nuk pati asnjë tentativë hakmarrjeje ndaj drejtuesve të pushtetit lokal që i përkisnin Partisë Demokratike.

## 3-Anarkizmi

Pavarsisht nga slloganet e propagandës zyrtare shqiptare se revoltat në Shqipëri ishin të organizuara qysh në fillim, një analizë e kujdesëshme të çon në konkluzionin se ato në fillim lindën spontanisht dhe jo të organizuara mirë. Në procesin e thellimit të tyre lindën dhe format e reja të organizimit si Komitetet e shpëtimit qytetar dhe grumbullimi i tyre në një qëndër të vetme. Tipari dallues i saj nuk qëndron tek organizimi, por tek etja për dinjitet kombëtar. Me këtë lëvizje dhe revoltë, shqiptarët i bënë të qartë klasës së tyre politike dhe politikës euroamerikane se duan të jetojnë ndryshe, se duan të jetojnë me dinjitet, se dinjiteti vetjak është i pandarë nga dinjiteti kombëtar.

Pikërisht sepse nuk ishte e organizuar mirë, ajo nuk e përballoi siç duhet një nga rreziqet që ju kanos qysh në fillim, anarkizmit. Analiza e veprimtarisë së saj dëshmon se nëqoftëse drejtuesit e kësaj lëvizjeje e përballuan siç duhet rrezikun e nacional-komunizmit dhe nacional-socializmit, ata nuk e përballuan siç duhet anarkizmin. Është kjo arsyeja që disa kohë pas shpërthimit të saj, revoltat popullore u ndeshën me dukuri dhe shfaqje anarkiste.

Në gjallërimin e anarkizmit në zonat ku lëvizja kombëtare ishte shumë e fuqishme, ndikoi shumë dhe veprimtaria e ish-pushtetit shqiptar i cili veproi në dy drejtime.

E para: Duke gjallëruar elementin hajdut dhe keqbërës në zonat ku shpërtheu revolta, për të krijuar pasiguri në popull, duke e ftohur popullin nga qëllimi i lëvizjes. Shpërthimi i burgjeve disa ditë pasi ishte krijuar qeveria e “ pajtimit ” kombëtar, lirimi dhe amnistia për mjaft elementë ordinerë dhe keqbërës ishte paralajmërimi i krijimit dhe daljes në skenë të dhjetra e dhjetra bandave që filluan të terrorizonin popullin, i cili tashmë ishte futur në shtëpira dhe e kishte lënë fatin e tij në duart e politikanëve të “ pajtimit kombëtar ”. Domethënëse ishte deklarata e parlamentit shqiptar në muajin tetor 1997, e cila bënte të ditur se në muajin shkurt me dekret të veçantë lirohen nga burgu rreth 50 vetë të dënuar

për krime të rënda ordinere.

E dyta: Ish-pushteti shqiptar armatosi mjaft elementë të cilët ishin besnikë të tij për të krijuar trazira. Ngjarjet e ndodhura në Shkodër, Tiranë apo Durrës ishin në thelbin e tyre veprime anarkiste dhe kaotike. Qëllimi i tyre ishte diskreditimi i Lëvizjes popullore për dinjitet kombëtar.

E treta: Psikologjia e dëshpërimit. Me kalimin e kohës, kur në sajë të veprimeve të kancelarive euroamerikane dhe partive politike shqiptare, Lëvizja dhe kërkesat e saj filluan të kanalizoheshin dhe shpreheshin me gjuhë politikanësh dhe diplomatësh, tek një pjesë e atyre që kishin marrë pjesë aktivisht duke rrezikuar dhe jetën e tyre, u kultivua psikologjia e dëshpërimit. Dëshpërimi tek njerzit që luftojnë për një gjë të madhe, e cila përdhohet nga politikanët dhe matrapazët politikë që lindin dhe shtohen gjithmonë pas betejës, është pragu i veprimeve indiferente ose veprimeve anarkiste.

Midis shpresës dhe zhgënjimit

Me kalimin e kohës, Lëvizja kombëtare shqiptare për dinjitet kombëtar, u fut në kornizat e politikës së partive politike shqiptare. Ndaj saj u ushtrua një trysni e egër propagandistike nga brenda dhe jashtë Shqipërisë. U përkrahën dhe u aktivizuan të gjitha partitë politike të opozitës shqiptare, deri dhe të papërfillura nga kancelaritë euroamerikane. Me ndihmën e faktorëve ndërkombëtare, ato u bënë shprehëse të aspiratave të Lëvizjes popullore shqiptare. Duke shfrytëzuar mungesën e drejtuesve të kësaj lëvizjeje, duke shfrytëzuar shpresën e shtresa të tëra njerëzish tek këto parti si dhe kushtet e pafavorshme ndërkombëtare, Lëvizja Popullore Shqiptare për dinjitet kombëtar, pushoi së ekzistuari.

Populli i cili mori pjese aktive ne kete Levizje, realisht ndihet popull i tradhetuar. Pesha e fjales “ i tradhetuar ”, eshte shume e madhe. Propaganda e partive politike shqiptare, te majta dhe te djathta, nuk e pranon ate. Por kete fjale me peshe shume te madhe emocionale, e pranon realiteti i zhvillimit te ngjarjeve ne Shqiperi, e pranon prapaskena e politikës shqiptare dhe politikës evropiane dhe boterore.

Per te krijuar nje perfytyrim me te plote dhe me te qarte per pohimin e mesiperem, lind e nevojshme dhe e domosdoshme, evidentimi dhe analiza e propagandes dhe politikës shqiptare dhe nderkombetare.

Në luftë, forcë e vetme, në bisedime, as palë e tretë

Ne negociatat e para qe u bene ne Shqiperi nga te derguarit e Evropes dhe veçanerisht nga ish kancelari austriak Vranicki, pas takimit me perfaqesuesit e kryengritjes, u hodh ideja qe ne bisedimet midis partive politike te opozites dhe pushtetit te merrte pjese si pale e trete edhe nje delegacion i kryengritësve. Ky propozim nuk u perkrah nga partia qe ishte ne pushtet. Por ai nuk u perkrah as nga partite e opozites duke perfshire dhe partine socialiste. Vetem nje nga perfaqesuesit kryesore te forumit per demokraci, intelektual i Fatos Lubonja këmbënguli per domosdoshmerine e pjesmarrjes se perfaqesuesve te kryengritjes ne bisedimet nderpartiake. Me vone dhe vete Vranicki siç duket i detyruar nga qarqet politike euroamerikane, hoqi dore nga kjo kerkese. Qysh nga ky moment fillon manipulimi i pare i Levizjes popullore shqiptare. Aspiratat dhe thelbi i saj filluan te mbroheshin nga partite politike te opozites, te cilat sic do ta tregonte koha do ti redaktonin keto kerkesa vetem ne luften per marrjen e pushtetit politik, megjithse ne propagande do te vazhdonin te dilnin si shprehese te deshirave dhe aspiratave te popullit te revoltuar. Ekziston nje fakt trondites i cili zë fill pas krijimit te te ashtuquajtures qeveri e “ pajtimit ” kombetar, i cili hedh poshte propaganden e seciles partie politike shqiptare



qe pretendoi apo qe vazhdon te pretendoje te jete shprehese e thelbit te kryengritjes popullore shqiptare. Disa dite pas krijimit te qeverise se pajtimit kombetar, te trembura nga permasat e revoltes popullore, te gjitha partite politike shqiptare, te majta dhe te djathta, i kerkuan bashkesise nderkombetare qe te dergonte ne menyre urgjente ne Shqiperi forcat shumekombeshe per te vendosur rendin dhe sigurine. Pavarsisht nga propaganda qe ju be ardhjes se ketyre forcave, pavarsisht nga motivimi, pavarsisht nga falenderimet qe ju bene atyre, fakti eshte trondites dhe domethenes. Klasa politike shqiptare me kete akt te turpshem, te dytin ne historine e shtetit shqiptar, pas ardhjes ne 1913 te forcave te huaja, pranoi se vendi te cilit ajo i perkiste nuk ishte gje tjeter por protektorat, paqja dhe siguria e te cilit ruhet me ushtare te huaj, pranoi te ishte e nenshtuar dhe e pazonja, pranoi ta perdhoste dhe nje here dinjitetin kombetar. Qysh me kete akt kjo klase politike e djathte apo e majte qofte u distancau perfundimisht nga Levizja popullore dhe thelbi i saj qe ishte dinjiteti kombetar. Te gjitha deklaratat e bera me vone, te gjitha intervistat nuk ishin gje tjeter vetem se nje shaka tragjike, nje maskerade politikanesh, me enderrat dhe aspiratat e atyre qe luftuan dhe u vrane. Per analistet dhe politologet, jo vetem distancimi i pushtetit eshte i kuptueshem, por po kaq i kuptueshem eshte dhe distancimi i partive politike te opozites, te majta apo te djathta qofshin. E perbashketa e gjithe partive politike shqiptare eshte filozofia e kozmopolitizmit si menyre te menduari dhe praktike jetese. Nisur nga kjo ne menyre te natyrshme ish pushteti ju kundervu egersisht kesaj levizjeje sepse ajo i hoqi pushtetin. Por dhe opozita pas marrjes se pushtetit do ti kundervihej asaj sepse thelbi i saj dhe gjallesa e ketij thelbi i rrezikon seriozisht pushtetin.

Pas zgjedhjeve te 29 Qershorit 1997, opozita shqiptare forca kryesore e se ciles ishte partia socialiste fitoi gjeresisht zgjedhjet me mbi dy te tretat. Pas ketij momenti fillon faza e dyte e manipulimit me cinik te thelbit te Levizjes popullore shqiptare. Nuk eshte problemi tek shifrat arithmetike se sa perfaqesues autentike te kesaj levizjeje u evidentuan si deputete apo shtetare, nuk eshte problemi tek fjalimet qe mbajne qeveritare te ndryshem. Problemi duhet pare ne thelbin e tij. Ish-opozita qe pas 29 Qershorit 1997 perben pushtetin shqiptar, ndoqi dhe vazhdon te ndjeke ndaj kryengritjes popullore shqiptare filozofine e pragmatizmit. Interesimi i saj eshte se si kjo Levizje te vazhdoje akoma ti sherbeje asaj per te qendruar sa me shume ne pushtet. Ne funksion te ketij pragmatizmi pushteti i pas 29 qershorit ndoqi dhe vazhdon te ndjeke dy rruge : Rruga e pare : Perballe opinionit nderkombetar. Ashtu si do ta shikojme dhe me poshte ne marreveshje me kancelarite euroamerikane dhe per tu bere plotesisht e besueshme ndaj tyre se ky pushtet tashme i ka prere plotesisht te gjitha urat me thelbin e Levizjes popullore shqiptare, propaganda e pushtetit shqiptar filloi dhe vazhdon te flase per luften e forcave te rendit kunder bandave ne jugun e vendit, pra ne zonat ku kjo levizje ishte shume e fuqishme. Ne emisione televizive filloi te flitet nga perfaqesuesit e pushtetit shqiptar per banalitete dhe vulgarizma te tilla si : A duhej te sulmoheshin depot apo jo, a duhet te qellonte ushtari apo jo. Cinizem i kulluar “ demokratik ”. Nga fjalori i propagandes zyrtare u hoq plotesisht togfjaleshi “ revolte popullore, kryengritje popullore, popull i armatosur ” etj. Vendin e ketij togfjaleshi e zuri togfjaleshi “ trazira, rremuja ” etj.